




AUTORITETI I
KONKURRENCËS



RAPORTI VJETOR 2025

PRIORITETET PËR VITIN 2026



competition@caa.gov.al



www.caa.gov.al

Përmbledhje

PJESA E PARË.....	3
ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.....	3
PJESA E DYTË:.....	3
ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS	3
2.1 Tregjet e monitoruara	4
2.2 Marrëveshje të ndaluara.....	12
2.3 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve.....	16
2.4 Abuzimi me pozitën dominuese	18
2.5 Kontrolli i përqendrimeve	23
PJESA E TRETË:	47
AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESEVE GJYQËSORE.....	47
3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....	47
3.2 Çështje të gjykuara në gjykatën administrative të apelit Tiranë	48
3.3 Çështje të gjykuara në Gjykatën e Lartë.....	49
3.4 Ekzekutimi i vendimeve të komisionit të konkurrencës.....	49
PJESA E KATËRT:.....	51
ADVOKACIA E KONKURRENCËS	51
4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt akteve normative	51
4.2 Promovimit i kulturës së konkurrencës	54
PJESA E PESTË.....	56
INTEGRIMI EVROPIAN dhe BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	56
5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian	56
5.2 Memorandume Bashkëpunimi.....	57
5.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar	58
PJESA E GJASHTË	61
ORGANIZIMI I AUTORITETIT.....	61
6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës	61
6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2025	61
6.3 Të ardhurat e realizuara	62
6.4 Trajnimet dhe rekrutimet	62
PJESA E SHTATË	64
PRIORITETET E AK PËR VITIN 2026.....	64
7.1 Zbatimi i ligjit.....	64
7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE	64

LISTË SHKURTIMESH

AK	Autoriteti i Konkurrencës
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
BE	Bashkimi European
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FNT	Fuqi të ndjeshme në treg
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
ICN	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
KE	Komisioni European
KK	Komisioni i Konkurrencës
Ligji nr. 9121/2003	Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-GVH/RCC	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik për Evropën Juglindore
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
RSH	Republika e Shqipërisë
TIA	Tirana International Airport
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
VKK	Vendim i Komisionit të Konkurrencës

PJESA E PARË

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 1070 prot.i AK, datë 11.12.2025, me lëndë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të miratuara nga komisionet parlamentare me projekt-rezolutë”, u njoh mbi një vlerësim paraprak të aktivitetit të AK për vitin 2024, nga Komisionet parlamentare dhe prioritetet e punës së AK në vazhdim.

AK vlerësoi shqetësimet e ngritura nga Komisionet parlamentare, nga ku konstatoi se një pjesë tyre janë trajtuar me prioritet nga AK në vitin 2025.

Në hartimin e prioritetëve për vitin 2026, AK ka patur në konsideratë çështjet e ngritura nga Kuvendi i Shqipërisë në këtë Projekt-Rezolutë.

PJESA E DYTË:

ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Konkurrencës ka kryer monitorime të thelluara dhe ka zhvilluar procedura hetimore në tregje me ndjeshmëri të lartë dhe ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, përfshirë konkretisht:

▪ 18 (tetëmbëdhjetë) monitorime:

1. Tregu i prodhimit, importit dhe shitjes së tullave të ndërtimit;
2. Tregu i importit dhe shitjes të lëndës së parë për prodhimin e mobiljeve MDF (Fibra e Dendësisë së mesme);
3. Tregu i tregtimit të vezëve;
4. Tregu i importit dhe tregtimit të elektroshtepiakeve (TV, lavatrice, kondicioner, frigorifer);
5. Tregu i barnave me ekskluzivitet ose janë alternativë e vetme në treg;
6. Tregu i shërbimeve bankare;
7. Tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri;
8. Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza”;
9. Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil;
10. Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës;
11. Tregu i transportit detar ndërkombëtar të udhetarëve në portin e Durrësit dhe të Vlorës;
12. Tregu me pakicë i shërbimeve celulare;
13. Tregu i shërbimit spitalor;
14. Tregu i transportit urban në Bashkinë Kamëz;
15. Tregu i grurit;
16. Tregu i tregtimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë;
17. Tregu i makinave elektrike dhe stacioneve të karikimit;
18. Tregu i tregtimit të produkteve të shportës ushqimore;

▪ **7 (shtatë) procedura hetimore:**

1. *Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve;*
2. *Tregu i transportit detar ndërkombëtar të udhetarëve në portin e Durrësit dhe të Vlorës;*
3. *Tregu me pakicë i shërbimeve të komunikimit celular;*
4. *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës;*
5. *Tregu i sigurimit të jetës për kredi;*
6. *Tregu i shërbimit spitalor;*
7. *Tregu i transportit urban në Bashkinë Kamëz.*


2.1 Tregjet e monitoruara

Në zbatim të nenit 28 dhe të nenit 29/1 të Ligjit nr. 9121/2003, Autoriteti i Konkurrencës (AK) kryen monitorimin dhe analizimin e kushteve të tregut me qëllim vlerësimin e zhvillimit të një konkurrence të lirë dhe efektive. Ky detyrim ligjor siguron vlerësimin sistematik të tregut për identifikimin e barrierave konkurruese, sjelljeve kufizuese dhe praktikave që mund të cenojnë funksionimin efikas të tregut.

Gjatë vitit 2025, AK ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 83 ankesa, prej të cilave për 3 ankesa janë aktivizuar procedurat e monitorimi, ndërsa pjesa e mbetur janë konstatuar si jashtë objektit të aplikimit të Ligjit nr. 9121/2003 dhe për këtë arsye nuk kanë sjellë nisje të procedurave formale të monitorimit.

Në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, AK ka kompetencë të nisë procedura monitorimi jo vetëm sipas kërkesave të palëve të interesuara, por edhe me iniciativë të saj (kryesisht), apo në zbatim të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, sa herë që lindin dyshime të arsyeshme për ekzistencë të praktikave, marrëveshjeve ose sjelljeve që mund të çojnë në shtrembërim të konkurrencës në treg.

Ky qasje siguron që AK të ushtrojë funksionet e saj kontrolluese dhe hetimore në mënyrë proaktive, duke mbrojtur efektivitetin konkurrues të tregut në përputhje me rregullat e mbrojtjes së konkurrencës.



Tregjet e monitoruara gjatë vitit 2025 paraqiten si më poshtë:

Tregje të monitoruara që nuk kanë kaluar në procedura hetimore (6)

- Tregu i prodhimit, importit dhe shitjes së tullave të ndërtimit

AK, gjatë vitit 2025 realizoi monitorim në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes së tullave të ndërtimit. Nga të dhënat e administruara dhe të vlerësuara nga DPT dhe DPD u evidentua se: në lidhje me çmimet mesatare mujore CIF dhe sasinë e importuar, u vu re se çmimet mesatare mujore ndryshonin sipas sasisë së importuar, ku kryesisht gjatë periudhave kur sasia e importit ishte e lartë çmimet mesatare mujore kishin një tendencë ulje, dhe gjatë periudhave kur sasia e importit ishte e ulët kishte një tendencë të lehtë në rritje. Në këtë treg operonin një numër i madh ndërmarrjesh prodhuese dhe tregtuese, ku dhe pjesa e tregut e secilës prej tyre ishte e vogël, për këtë arsye edhe treguesit e përqendrimit si HHI, CR3 dhe CR5 ishin në nivele të ulëta.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë numrin e madh të ndërmarrjeve importuese, përqendrimin e ulët të tregut të prodhimit dhe shitjes, rezultoi se në këtë treg nuk u vunë re shenja të një sjellje të mundshme antikonkurrese në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

- Tregu i importit dhe shitjes të lëndës së parë për prodhimin e mobiljeve MDF (Fibra e Dendësisë së mesme)

Gjatë vitit 2025, AK realizoi monitorim të importit dhe shitjes të lëndës së parë për prodhimin e mobiljeve MDF. Për mbledhjen e të dhënave për monitorimin e këtij tregu u kërkuar informacion nga DPD dhe DPT në lidhje me subjektet tregtare të cilat operojnë në tregun e importit dhe tregtimit të lëndës së parë për prodhimin e mobiljeve MDF dhe xhiron përkatëse të tyre. Nga të dhënat e administruara nga DPT, u konstatua se në tregun e tregtimit të produktit MDF ushtrojnë veprimtari rreth 420 ndërmarrje.

Nga monitorimi i kryer në mobilitet, të cilat janë përdorues të produktit MDF, u vërejt se nuk kishte asnjë ankesë apo problematikë në lidhje me këtë treg. Në përfundim u konstatua se në tregun e tregtimit të lëndës së parë për prodhimin e mobiljeve nuk u vunë shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës sipas nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

- Tregu i tregtimit të vezëve

AK, në vijim të një ankese të paraqitur, realizoi një monitorim në tregun e tregtimit të vezëve, për të parë kushtet e këtij tregu. Për mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të nevojshme lidhur me monitorimin e këtij tregu, u kërkuar të dhëna dhe informacion nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me ndërmarrjet aktive/pularitet dhe numrin e krerëve që prodhojnë vezë si dhe nga DPT në lidhje me të ardhurat tatimore të realizuara gjatë vitit 2024 për ndërmarrjet që operonin në tregun e prodhimit të produktit të vezëve.

Nga monitorimi në tregun e tregtimit të vezëve, u evidentua, se nuk kishte indicie për të filluar procedurën e hetimit paraprak, pasi nuk u vunë re shenja të një sjellje antikonkurrese në kuptim të nenit 4 ose 9 të ligjit nr. 9121/2003.

- Tregu i importit dhe tregtimit të elektroshtepiave (TV, lavatrice, kondicioner, frigorifer)

AK realizoi monitorimin e tregut të pajisjeve elektroshtëpiake për evidentimin e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes së pajisjeve elektroshtëpiake, sipas niveleve import, shitje me shumicë dhe shitje me pakicë. Nga informacioni i DPD dhe DPT u konstatua se për vitin 2025, kishin importuar artikuj elektroshtëpiake rreth 1822 subjekte tregtare dhe individë, ndërsa për periudhën Janar – Gusht 2025 u vu re se kishin importuar artikuj elektroshtëpiake rreth 1472 subjekte tregtare dhe individë.

Subjektet importues kryesorë ishin: Neptun sh.p.k., AZA ELEKTROSHTËPIAKE, GLOBE SHOPS, GO TECH, SECURITY SOLUTION & DISTRIBUTION, GORENJË – ALBANIA SHPK, ALB – ZEUS SHPK, Elektromagjia SHPK etj. Referuar, vlerës CIF për 10 subjektet importues më të mëdhenj u konstatua se ajo varionte nga 2% deri në 22%.

Përsa me sipër, nga monitorimi i çmimeve të shitjes së pajisjeve elektroshtëpiake u konstatua se nuk u vunë re shenja të sjelljes së mundshme antikonkurruese nga subjektet që operojnë në këtë treg, në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i barnave me ekskluzivitet ose janë alternativë e vetme në treg*

AK realizoi monitorim në tregun e shitjes së barnave, të cilat kishin ekskluzivitet ose ishin alternativë e vetme në treg. Me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme, u kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, si dhe nga ndërmarrjet prodhuese të barnave: A&A PHARMA SHPK, PROFARMA SHA, FLORFARMA SHPK, LEKLI SHPK dhe TWO BEE SHPK.

Nga vlerësimi i informacionit të administruar gjatë monitorimit rezultoi se, nga 5 ndërmarrjet prodhuese të barnave, vetëm ndërmarrja Profarma SHPK prodhonte barna, të cilat ishin alternativë e vetme në treg.

Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.2.2015 “Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 01.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, janë përcaktuar kritere dhe mekanizma të cilët kontrollojnë/përcaktojnë çmimin e shitjes me shumicë dhe pakicë të barnave të regjistruar dhe pajisjen e barnave me pullën e kontrollit të barnave .

Sa më sipër çmimi i barnave në treg, edhe gjatë vitit 2025 vazhdon të jetë i kontrolluar dhe bazohet mbi çmimet CIF të importit, të deklaruar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit dhe mbi bazën e çmimeve të prodhimit për barnat e prodhuara në vend, të deklaruar nga prodhuesi vendas.

- *Tregu i shërbimeve bankare*

AK monitoroi tregun e shërbimeve bankare dhe vlerësoi se tregu karakterizohet nga një nivel i kufizuar i transparencës dhe harmonizimit të tarifave, sidomos për komisionet e aplikuara ndaj kartëmbajtësve të huaj dhe përdorimin e rrjeteve të bankomateve të nënkontraktuara.

Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1193, datë 26.06.2025 “Për dhënien e disa rekomandimeve Bankës së Shqipërisë për tregun e shërbimeve bankare në bankomate”, vendosi si vijon:

- I. T’i rekomandojë Bankës së Shqipërisë, si institucioni mbikëqyrës i veprimtarisë bankare të bankave të licencuara në Republikën e Shqipërisë, që me qëllim sigurimin e një konkurrence

të ndershme dhe transparente në tregun e shërbimeve bankare në bankomate, të marrë masat e mëposhtme:

- i. Të kontrollojë metodologjinë për llogaritjen e komisioneve për tërheqjet në bankomate, si dhe për kartëmbajtësit vendas ashtu edhe për ata të huaj, duke përfshirë edhe ‘mark-up’ për shërbimin e Këmbimit Dinamik të Valutës (DCC), nëse praktikatat e ndjekura nga bankat janë në përputhje me aktet rregullative në fuqi.
- ii. Të kërkojë nga bankat raportim periodik dhe publikim të komisioneve në një format të unifikuar, të aksesueshëm për publikun në faqet e tyre zyrtare dhe në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
- iii. Bazuar në rezultatet e kontrolleve sipas pikës “I/i” të këtij vendimi, të shqyrtojë nevojën për ndërhyrje rregullatore që lidhen me përdorimin e rrjeve të nënkontraktuara të bankomateve, me qëllim parandalimin e aplikimit të komisioneve disproporcionale.

Tregje të monitoruara në zbatim të Vendimeve të KK gjatë 2024 (4)

- *Tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri*

KK me vendimin nr. 1091, datë 01.07.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë dhe gjëbajtjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për abuzim me pozitën dominuese”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë.
- II. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri.
- III. Gjëbajtjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, në shumën 97,700,736 (nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) Lekë.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

Në zbatim të pikës IV të këtij Vendimi, AK monitoroi sjelljen e ndërmarrjes Antea Cement SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri, për periudhën 1 (një) vjeçare pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Nga monitorimi rezultoi se, sjellja e ndërmarrjes Antea Cement SHA gjatë periudhës së monitorimit paraqiti elemente si, ndryshime në çmime, kosto dhe marzhe fitimi, praktika kontraktuale, të cilat kërkojnë një monitorim të mëtejshëm dhe vlerësim e analizë më të gjerë, si dhe çështja gjyqësore në vazhdim lidhur me vlefshmërinë e VKK nr. 1091/2024, imponon mbajtjen nën kontroll të sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese në funksion të mbrojtjes së konkurrencës efektive.

Si përfundim, KK me vendimin nr. 1251, datë 29.12.2025, “Për monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1091, datë 01.07.2024”, ka vendosur:

I. Zgjatjen e periudhës së monitorimit të sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri, për një periudhë shtesë 2 (dy) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

Në zbatim të pikës I të VKK nr. 1251, datë 29.12.2025, Autoriteti do të vijojë procedurat e monitorimit të sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri edhe për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

- *Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport)*

KK, me vendimin nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, gjobitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si dhe detyrimin e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese.

Nga informacioni i administruar gjatë monitorimit të VKK nr. 921/2022, rezultoi se: lidhur me zbatimin e pikës III/a të VKK nr. 921/2022, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk kishte hartuar një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepas-it; lidhur me zbatimin e pikës III/b të VKK nr. 921/2022, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk zbatonte tarifa të orientuara drejt kostos, ky fakt përforcohej edhe nga mos zbatimi i një metodologjie apo prej normave të fitimit mbi 40%; lidhur me zbatimin e pikës III/c të VKK nr. 921/2022, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK kishte zbatuar kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas dhe nuk paraqiti arsye për këtë trajtim të ndryshëm.

Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, vendosi: vijimin e monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të vendimit të KK nr. 921/2022 për një periudhë 1 vjeçare dhe gjobitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK.

Në përfundim të monitorimit të zbatimit të VKK rezultoi se, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK kishte zbatuar kushtet dhe detyrimet dhe për këto arsye nga KK, me vendimin nr. 1202, datë 25.07.2025 “Mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, vendosi për mbylljen e montorimit të zbatimit të VKK nr. 1084/2024.

- *Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil*

KK, me Vendimin nr. 1101, datë 29.08.2024 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, vendosi përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil për një periudhë 2 vjeçare, me kushte dhe detyrime dhe rekomandime për BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit.

AK në vijim të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi ka bashkëpunuar me AMF, BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit duke kërkuar informacion për zbatimin e vendimit. Monitorimi vijon deri në 02.07.2026.

- *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës;*

KK, me Vendimin nr. 1143, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen S&D Invest SHA”, vendosi për mbylljen hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes S&D Invest SHA, miratimin e angazhimeve në formën e kushteve dhe detyrimeve si dhe monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes S&D Invest SHA për një periudhë 1 vjeçare.

KK, me Vendimin nr. 1144 datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Acrem SHPK”, vendosi për mbylljen hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Acrem SHPK, disa kushte dhe detyrime si dhe monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Acrem SHPK për një periudhë 1 vjeçare.

KK, me Vendimin nr. 1145, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjëritjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”, vendosi për mbylljen hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK, disa kushte dhe detyrime si dhe monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK për një periudhë 1 vjeçare.

AK po vijon me monitorimin e sjelles së ndërmarrjeve S&D Invest SHA, Acrem SHPK dhe Tirana Administrim SHPK.

Tregje të monitoruara dhe të kaluara në procedurë hetimore (4)

- *Tregu i transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe të Vlorës*

AK gjatë muajit Qershor 2025, realizoi monitorimin e tregut të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe portin e Vlorës, me qëllim evidentimin e shenjave të kufizimit dhe shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg. KK, në përfundim të monitorimit, me vendimin nr. 1194, datë 21.07.2025, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”, u hap hetimi paraprak në këtë treg, për periudhën kohore 1 Janar 2022 deri në 30 Qershor 2025.

- *Tregu me pakicë i shërbimeve celulare*

Nga informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit rezultoi se sjellja e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare ngrinte dyshime për kufizim të konkurrencës sipas neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, ndaj me Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025, u hap hetimi paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Në përfundim të tij, duke qenë se tregu paraqiste strukturë duopolistike, vihej re një sinkronizim në rritjen e çmimeve dhe oferta pothuajse të njëjta në çmime dhe përmbajtje; mungonte transparenca dhe metodologjia kosto-çmim, KK, me Vendimin nr. 1226, datë 18.11.2025, vendosi për hapjen e hetimit të thelluar. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 18 nëntor 2025, dhe është në proces.

- *Tregu i shërbimit spitalor*

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të RSH, “Për vlerësimin e veprimtarisë së AK për vitin 2022”, dhe nenit 28 të Ligjit nr. 9121/2003, AK monitoroi tregun e shërbimit spitalor privat për të vlerësuar kushtet e konkurrencës. Nga monitorimi u krijuan dyshime për kufizim të konkurrencës sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, ndaj KK, me Vendimin nr. 1173, datë 09.04.2025, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor.

Gjatë hetimit paraprak nuk rezultuan prova të mjaftueshme që të mbështesin konstatimin e një shkeljeje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, pasi mungonin elementët thelbësorë lidhur me shkeljen e pretenduar, për këto arsye KK, me Vendimin nr. 1197, datë 21.07.2025, vendosi për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor dhe monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve për një periudhë 1 vjecare.

- *Tregu i transportit urban në Bashkinë Kamëz*

AK nisi procedurën e monitorimit pas ankesave të depozituara pranë AK dhe shqetësimeve të bëra publike në media nga ku u konstatua se, ndërmarrja SHPRESA – AL SHPK ishte i vetmi operator i licencuar për ofrimin e shërbimit të transportit urban në këto linja, duke zotëruar pozitë dominuese në treg, në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003. Gjithashtu, nuk u administruan analiza të plota ekonomike apo financiare që të vërtetonin se rritja e tarifave mbështetej në rritje reale të kostove, ishte ekonomikisht e domosdoshme dhe e justifikuar mbi baza objektive të tregut. Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1246, datë 12.12.2025 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 1 janar 2025 deri në 12 dhjetor 2025, dhe është në proces.

Monitorime në vazhdim (4)

- *Tregu i grurit*

AK, ka nisur monitorim në tregun e grurit. Nga DPD u kërkua informacion: lidhur me importet e realizuara për produktet grurë sipas subjekteve importuese për periudhën 1 gusht 2023 deri në 30 tetor 2025; si edhe bursën ndërkombëtare të grurit për periudhën 1 gusht 2023 deri në 30 tetor 2025. Informacioni i ardhur është duke u analizuar me qëllim evidentimin e luhatjeve të çmimeve nëse ka, ndërmarrjeve më të mëdha importuese dhe pjesët e tregut, vendin e origjinës

së grurit të importuar. Afati për përfundimin e monitorimit dhe analizimin e të dhënave, përfundon në Janar 2026.

- *Tregu i tregtimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë*

Nisur nga një trend në rritje i çmimit të kafesë dhe me qëllim analizimin e kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, AK, gjatë vitit 2025 vendosi të realizojë monitorimin e tregut të tregtimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë. Për mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të nevojshme lidhur me monitorimin e këtij tregu dhe në bashkëpunim DPD dhe AKU, u evidentuan subjektet tregtare, të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e përpunimit dhe tregtimit të kafesë, si dhe u administruan të dhëna në lidhje me sasinë e importuar, sipas kategorisë së kafes, për subjektet importuese, që prej datës 1 janar 2023 e në vazhdim.

Nga analiza e konkurrencës, u evidentua se tregu i importit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë është një treg i zëvendësueshëm nga ana e ofertës dhe nga ana e kërkesës. Kafeja kokërr e papjekur zinte pjesën më të madhe të importit të kafesë, me rreth 50-60%, duke shërbyer si lëndë e parë për industrinë e përpunimit dhe ambalazhimit të kafes në vend. Sipas të dhënave të AKU, në këtë treg ushtronin veprimtarinë rreth 148 subjekte.

Duke qënë se çmimi i bursës ishte në rritje, ky monitorim ka vijuar gjatë gjithë vitit 2025.

- *Tregu i makinave elektrike dhe stacioneve të karikimit*

AK gjatë vitit 2025, ka nisur monitorim në tregun e makinave elektrike dhe stacioneve të karikimit, për të parë nëse kushtet e këtij tregu. Për mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të nevojshme lidhur me monitorimin e këtij tregu, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga DPD në lidhje me numrin e makinave elektrike të importuara, si dhe nga ERRE në lidhje me legjislacionin në fuqi të stacioneve të karikimit. Afati për përfundimin e monitorimit dhe analizimin e të dhënave, përfundon në Janar 2026.

- *Tregu i tregtimit të produkteve të shportës ushqimore*

AK, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës dhe interesave të konsumatorëve, në lidhje me produktet e shportës realizoi monitorim në terren *gjatë periudhës së festave të fundvitit 2024* për çmimet e produkteve të shportës ushqimore. Festat e fundvitit karakterizohen zakonisht nga rritja e kërkesës për produkte bazë ushqimore, çka ndikon edhe në luhatjet sezonale të çmimeve dhe krijon një rrezik potencial për abuzim nga ana e ndërmarrjeve tregtare në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003. Monitorimi evidentoi se supermarketet ofronin një gamë të gjerë produktesh të së njëjtës kategori nga prodhues dhe importues të ndryshëm, duke krijuar nivel të lartë zëvendësueshmërie brenda kategorisë dhe elasticitet të ndjeshëm të kërkesës. Kjo i mundëson konsumatorëve të kalojnë lehtësisht nga një markë në tjetrën në bazë të çmimit, cilësisë dhe karakteristikave të produktit. Nga analiza e çmimeve për produktet bazë të shportës ushqimore: vaj, miell, oriz, makarona, ujë, kripë, sheqer, pije joalkolike dhe vezë, për periudhën dhjetor 2024–janar 2025, nuk u identifikuan shenja të një sjelljeje të mundshme antikonkurruese në kuptim të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Në vijim të monitorimeve, **gjatë fundit të vitit 2025**, AK nisi një cikël të ri kontrollesh në terren dhe mbledhje të të dhënave mbi çmimet e produkteve të shportës ushqimore, për periudhën tetor–dhjetor 2025, në rrjetet kryesore të supermarketeve në qytetin e Tiranës. Pas përfundimit të grumbullimit të të dhënave, do të realizohet një analizë e detajuar krahasuese për secilin

produkt, me qëllim identifikimin e çdo rritjeje të pajustificuar të çmimeve që mund të lidhet me sjellje jo konkurruese ose koordinim të paligjshëm ndërmjet operatorëve ekonomikë. Analiza do të fokusohet në krahasimin e nivelit të çmimeve para festave, gjatë festave dhe pas festave të fundvitit, për të vlerësuar dinamikën e tregut dhe për të identifikuar nëse ka elemente që mund të rezultojnë në sjellje të mundshme në kundërshtim me rregullat e konkurrencës.

MARRËVESHJE TË NDALUARA

TREGU I GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA

MARRËVESHJE TË PËRJASHTUARA NGA NDALIMI

TREGU I SIGURIMEVE PËR PRODUKTIN TPL

TREGU I SHITJES SË CIGAREVE PA DJEGJE QË PËRMBAJNË NIKOTINË

ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE

TREGU I TRANSPORTIT DETAR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE NË PORTIN E DURRËSIT DHE TË VLORËS

TREGU ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE

TREGU I AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT TË QARKUT TË TIRANËS

TREGU I SIGURIMIT TË JETËS PËR KREDI

TREGU I SHËRBIMIT SPITALOR

TREGU I TRANSPORTIT URABAN NË BASHKINË KAMËZ

2.2 Marrëveshje të ndaluara

- *Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve*

KK me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, për periudhën kohore nga 1 Janar 2023 deri në 30 Shtator 2024.

Në përfundim të hetimit rezultoi se: ndërmarrjet Omer Fruit SHPK, Nedrete Arapi PF, Besim Thaqi PF, Morina Grup SHPK, Fruit-To-Zela SHPK, Roland-2012 SHPK, periodikisht nëpër periudhë sezoni, kanë caktuar çmimet e blerjes/grumbullimit, duke koordinuar dhe diktuar çmimet, si dhe aplikojnë mark-up shumë të larta (deri në 115%), duke përdorur fuqinë negociuese në përcaktimin e çmimeve të blerjes kundrejt fermerëve, si rrjedhim kjo sjellje e bashkërenduar e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, që caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e blerjes të produkteve nga

fermerët, në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, gërma a) e ligjit nr. 9121/2003, përbën një marrëveshje të ndaluar, shkelje e cila në bazë të nenit 74, vlerësohet si shkelje e rëndë e ligjit dhe vendoset gjobë nga KK në masën deri 10% të xhiros së vitit financiar paraardhës.

Për këto arsye KK u shpreh me vendimet e mëposhtme:

Me vendimin nr. 1234, datë 26.11.2025, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Fruit-To-Zela SHPK për shkelje të konkurrencës”, KK vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.*
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes Fruit-To-Zela SHPK, me numër NUIS L63217001H për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 571,908 Lekë (pesëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e tetë).*
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Fruit-To-Zela SHPK për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përditësuara të produkteve që grumbullon.*
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Fruit-To-Zela SHPK, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.*

Me vendimin nr. 1235, datë 26.11.2025, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Besim Thaqi PF për shkelje të konkurrencës”, KK vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.*
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes Besim Thaqi PF, me numer NUIS L84519402Q për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 237,911 Lekë (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë).*
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Besim Thaqi PF për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përditësuara të produkteve që grumbullon.*
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Besim Thaqi PF, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.*

Me vendimin nr. 1236, datë 26.11.2025, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Morina Grup SHPK për shkelje të konkurrencës”, KK vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.*
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes Morina Grup SHPK, me numer NUIS L53729401N për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003,*

në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 676,107 Lekë (gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatë).

III. Detyrimin e ndërmarrjes Morina Grup SHPK për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përfitësuar të produkteve që grumbullon.

IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Morina Grup SHPK, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

Me vendimin nr. 1237, datë 26.11.2025, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Nedrete Arapi PF për shkelje të konkurrencës”, KK vendosi:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

II. Gjobitjen e ndërmarrjes Nedrete Arapi PF, me numër NUIS L44704402M për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërmat gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 423,005 Lekë (katërqind e njëzet e tremijë e pesë).

III. Detyrimin e ndërmarrjes Nedrete Arapi PF për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përfitësuar të produkteve që grumbullon.

IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Nedrete Arapi PF, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

Me vendimin nr. 1238, datë 26.11.2025, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Roland-2012 SHPK për shkelje të konkurrencës”, KK vendosi:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

II. Gjobitjen e ndërmarrjes Roland-2012 SHPK, me numer NUIS L23513001P për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 355,172 Lekë (treqind e pesëdhjetë e pësëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy).

III. Detyrimin e ndërmarrjes Roland-2012 SHPK për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përfitësuar të produkteve që grumbullon.

IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Roland-2012 SHPK, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

Me vendimin nr. 1239, datë 26.11.2025, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Korçë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Omer Fruit SHPK për shkelje të konkurrencës”, KK vendosi:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

II. Gjobitjen e ndërmarrjes Omer- Fruit SHPK, me NUIS L82715001M për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr.

9121/2003, në masën 0.15 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 1,000,000 Lekë (një milion).

- III. *Detyrimin e ndërmarrjes Omer- Fruit SHPK për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përditësuara të produkteve që grumbullon.*
- IV. *Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Omer- Fruit SHPK, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.*

Gjithashtu bazuar në gjetjet e hetimit, me qëllim përmirësimin e konkurrencës në tregun e prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve u vlerësua si shumë të rëndësishme aplikimi i disa masave rregulluese adresimi i të cilave mund të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të drejtë dhe konkurrues për fermerët dhe grumbulluesit, ku të dyja palët mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të ndihmojnë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe rritjen e konkurrencës në treg si: *Rritja e transparencës dhe informacionit në treg*: Krijimi i një sistemi të qartë dhe të hapur të informacionit për çmimet reale në treg, cilësinë dhe kërkesat e tregut, që ju mundësojnë fermerëve të marrin vendime më të informuara dhe të kenë më shumë mundësi për të negociuar kushte më të mira me grumbulluesit; *Lidhja e kontratave me kushte të drejta dhe të qarta*: Hartimi dhe aplikimi i kontratave të detyrueshme dhe të standartizuara të cilat të përmbajnë kushte të qarta dhe të drejta tregtimi për të dyja palët, duke krijuar siguri dhe mbroje për fermerët nga presioni i çmimeve të ulëta, vonesat në pagesa, apo kërkesa të padrejta lidhur me cilësinë, afatet e dorëzimit të produkteve etj; Ndërmarrja nga ana e institucioneve ligjzbatuese dhe zbatimi i masave konkrete për *reduktimin e informalitetit* në treg me qëllim krijimin e një mjedisi konkurrues për fermerët dhe grumbulluesit e fruta perimeve.

Për këto arsye, KK me vendimin nr.1240, datë 26.11.2025 vendosi:

I. T'i rekomandojë Ministrisë së Financave që:

- *Të ndërmarrë masa konkrete për të minimizuar informalitetin në tregun e prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve, si insitucioni kompetent dhe përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e informalitetit në treg, me qëllim krijimin e një mjedisi konkurrues për fermerët dhe grumbulluesit e fruta perimeve.*

II. T'i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që:

- *Të ndërmarrë nismën për hartimin dhe plotësimin e bazës ligjore për tregun e prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian për mirëfunksionimin e të gjitha niveleve të tregut, me qëllim rritjen e konkurrencës në treg, duke pasur në konsideratë të veçantë vendosjen e mekanizmave për të detyruar grumbulluesit që të shlyejnë pagesat e prapambetura, si p.sh: nëpërmjet hartimit dhe aplikimit të kontratave të detyrueshme dhe të standartizuara të cilat të përmbajnë kushte të qarta dhe të drejta tregtimi për të dyja palët, duke krijuar siguri dhe mbroje për fermerët nga presioni i çmimeve të ulëta, vonesat në pagesa, apo kërkesa të padrejta lidhur me cilësinë, afatet e dorëzimit të produkteve etj.*

- *Të bashkëpunojë me AK gjatë përafrimit dhe transpozimit të Direktives së Bashkimit Europian “Unfair Trade Practice” UTP nr. 663/2019 për zgjidhjen e problematikave në zinxhirin ushqimor.*
- *Të ndërmarrë nismën për krijimin e një platforme elektronike (bursë) për çmimet e fruta perimeve në të gjitha hallkat e tregtimit, me qëllim rritjen e konkurrencën përmes transparencës dhe krahasueshmërisë me të mirë të këtyre çmimeve online.*

Dhënien e rekomandimit për ndërmarrjet grumbulluese në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve, për afishimin në një vend të dukshëm pranë biznesit, të çmimeve të përditësuara të produkteve që grumbullojnë.

2.3 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve

AK, bazuar në nenin 5 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121/2003 si dhe në aktet nënligjore, përjashton nga ndalimi marrëveshjet që kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose në shpërndarjen e produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve dhe të konsumatorëve dhe kur:

- 1) Nuk përmbajnë kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;
- 2) Nuk kufizojnë, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.

Gjatë vitit 2025, KK ka vlerësuar 2 raste të përjashtimit nga ndalimi të Marrëveshjeve:

- *Tregu i sigurimeve për produktin TPL*

Në mbështetje të Ligjit nr. 9121/2003, Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”, BSHS, depozitoi për vlerësim ligjor “Marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.

Për sa më sipër, KK, me vendimin nr. 1227, datë 18.11.2025, “Për vlerësimin ligjor mbi “Marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””, vendosi:

- I. Marrëveshja e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, për nga objekti dhe qëllimi është në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 dhe me Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”.
- II. Në marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, të shtohen kushtet dhe detyrimet si më poshtë vijon:
 - i. marrëveshja të mos kufizojë produktin MTPL apo shitjet;
 - ii. marrëveshja të mos ndajë tregun apo klientët që blejnë produktin MTPL dhe;
 - iii. ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje bashkëpunimi në asnjë rast nuk duhet të dakordësohen për primet e shitjes, të zbatuara për produktin MTPL.
- III. Në pikën II.2 “Qëllimi i marrëveshjes” të ndryshohet dhe të shtohet:

- i. Qëllimi i marrëveshjes është rritja e efikasitetit në trajtimin e dëmeve dhe uljen e numrit të mjeteve të pasiguruara;
- ii. Shkëmbimi i informacionit do të kufizohet vetëm në të dhënat statistikore dhe të përmbledhura, për të përmirësuar njohuritë mbi rreziqet dhe vlerësimin e riskut nga secila ndërmarrje, pa penguar dhe kufizuar konkurrencën në treg si dhe vendimmarrjen e pavarur të palëve;
- iii. Periudha kohore për të cilën do të shkëmbehet informacioni me qëllim realizimin e llogaritjeve të përbashkëta, tabelave dhe studimeve të përbashkëta.

IV. Në pikën II.3 “Detyrimet e palëve” të ndryshohet dhe të shtohet:

- i. Palët kanë detyrimin që të mos japin asnjë informacion mbi çmimet, primet, kostot, fitimet apo çdo element tjetër që mund të ndikojë në përcaktimin e çmimit fundor të policës MTPL;
- ii. Palët duhet të raportojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës për masat e ndërmarra për sigurimin e mosfalsifikimit të policave MTPL të brendshme;
- iii. Palët vendosin në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës informacionin e shkëmbyer sipas marrëveshjes sa herë që kërkohet.
- iv. Të hiqet pika 8 ku thuhet: “Tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta vetëm në pikat e autorizuar të seilës prej kompanive”.

V. Në pikën II.6 “Kontrolli i zbatimit të marrëveshjes” të shtohet:

- i. Në rast përjashtimi të palëve nga marrëveshja, duhet të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për këtë fakt;
- ii. Byroja Shqiptare e Sigurimeve do të monitorojë zbatimin e marrëveshjes sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij vendimi, duke siguruar që marrëveshja të mos kufizojë produktin MTPL apo shitjet, të mos ndajë tregun apo klientët që blejnë produktin MTPL dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje bashkëpunimi duhet të mos kenë rënë dakord për primet e shitjes, të zbatuara për produktin MTPL.

VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje shoqëritë e sigurimeve që kanë nënshkruar këtë marrëveshje kanë marrë përsipër angazhime dhe detyrime të cilat do të monitorohen rreptë nga Autoriteti i Konkurrencës në vijim. Mos përmbushja e këtyre detyrimeve dhe angazhimeve që janë shumë të qarta, do të sillte penalizimin e shoqërive të sigurimit bazuar në dispozitat përkatëse të ligjit 9121/2003.

- *Shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve të lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.*

KK, me vendimin nr. 983, datë 11.05.2023 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”, vendosi të përjashtojë nga ndalimi “Marrëveshjen Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, “Marrëveshjen për Licencën e Markës Tregtare” dhe “Marrëveshjen e Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën”, të lidhura ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation për një periudhë 2 vjeçare nga marrja e vendimit.

Në përfundim të periudhës së përjashtimit dhe në zbatim të nenit 50 “Vendimi për përjashtime individuale”, pika 4 e ligjit nr. 9121/2003 palët në marrëveshje njoftuan për zgjatjen e Përjashtimit Individual të marrëveshjes.

AK konstatoi se hedhja në treg e produkteve KT&G në tregun shqiptar nga PMI nuk solli ndonjë efekt negativ në hyrjen apo rritjen e konkurrentëve aktualë apo potencialë në Shqipëri.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1175, datë 24.04.2025, “Mbi shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve të lidhura midis shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.”, vendosi të shtyjë afatin e përjashtimit nga ndalimi të “Marrëveshjes Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, “Marrëveshjes për Licencën e Markës Tregtare” dhe “Marrëveshjes së Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën”, të lidhura ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation, për një periudhë 2(dy) vjeçare nga marrja e vendimit.

2.4 Abuzimi me pozitën dominuese

- *Tregu i transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe të Vlorës*

KK me vendimin nr. 1194, datë 21.07.2025, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, për periudhën kohore 1 Janar 2022 deri në 30 Qershor 2025.

Gjatë periudhës së hetimit paraprak u kërkuan të dhëna dhe informacion nga Agjencitë Detare përfaqësuese të operatorëve të trageteve, që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës, MIE, Autoritetin Portual Durrës dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës. Nga ana e MIE nuk u depozitua asnjë përgjigje mbi informacionin e kërkuar, informacion i cili është i rëndësishëm për vlerësimin dhe analizimin e plotë të sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës, veçanërisht për ndërmarrjet me pozitë dominuese në këtë treg.

Sa më sipër KK çmoi se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, veçanërisht për ndërmarrjet me pozitë dominuese, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1245, datë 12.12.2025, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1194, datë 21.07.2025, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”” vendosi që:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1194, datë 21.07.2025, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”, pika 3 (tre) e dipozitivit të ndryshohet si vijon: “3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 Janar 2026.”

Ky hetim aktualisht është në përfundim por do të jetë pjesë e raportimit për vitin 2026.

- *Tregu me pakicë të shërbimeve celulare*

Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit, sjellja e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare ngrinte dyshime për kufizim të konkurrencës, në kuptim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Në përfundim të hetimit paraprak, në kushtet kur: tregu paraqiste një strukturë duopolistike; u vu re një sinkronizim në rritjen e çmimeve dhe oferta pothuajse të njëjta në çmime dhe përmbajtje; mungonte transparenca dhe metodologjia kosto-çmim, atëherë sjellja e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA mund të përbënte shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1226, datë 18.11.2025 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 18 nëntor 2025, dhe është në proces.

- *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës;*

KK, me Vendimin nr. 1142, datë 27.12.2024, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi për shtyrjen e hetimit të thelluar për ndërmarrjet D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit deri në 13.02.2025.

Në përfundim të analizës së hetimit të thelluar, u konstatua se pretendimet nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit për refuzimin e aksesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte pasi nuk disponohet një korrespondencë shkresore në përgjigje të lejit apo mos lejit të aksesit. Për këto arsye:

KK, me Vendimin nr. 1168, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes D&L Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.

KK, Vendimin nr. 1169, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit

ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.

KK, me Vendimin nr. 1170, datë 26.03.2025 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Safe Security Albania SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.

- *Tregu i sigurimit të jetës për kredi*

KK, me vendimin Vendim nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak u konkludua se sjellja e bankave mund të përbënte shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe ABI Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës ProCredit SHA”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar për të vlerësuar sjelljen e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi, për periudhën kohore nga 7 nëntor 2021 deri në 26 mars 2025.

Gjatë procedurës së hetimit të thelluar u realizuan komunikime të vazhdueshme me bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimit dhe kredimarrësit, si në formë shkresore ashtu edhe përmes intervistave e inspektimeve. Shumë nga përgjigjet e ardhura ishin jo ezauruese për Sekretariatën e AK, çka ka detyruar të ri-kërkohet informacion dhe të bëhen kërkesa për saktësim ose plotësim të të dhënave të paraqitura. Koha e mbetur pas depozitimit të informacionit rezultoi e

pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe analizimin e sjelljes së bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke e bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e KK nr. 1171, datë 26.03.2025.

Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1215, datë 26.09.2025, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës ProCredit SHA”, vendosi që pika “III”, të ndryshohet si vijon: “III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 10 Tetor 2025.”.

Aktualisht Autoriteti i Konkurrencës është në përfundim të këtij hetimi dhe vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës do jetë pjesë e raportimit për vitin 2026.

- Tregu i shërbimit spitalor

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”, ku i është kërkuar Autoritetit të ndërmarrë monitorim ose hetim në tregun e shërbimit spitalor privat për të vlerësuar gjendjen e konkurrencës në këtë treg, AK ka vepruar sipas Ligjit nr. 9121/2003

Në përmbushje të përgjegjësiave të parashikuara në Ligjin nr. 9121/2003 AK ka analizuar kushtet e tregut të shërbimit spitalor privat dhe sjelljen e ndërmarrjeve kryesore në këtë sektor, duke vlerësuar nëse aktiviteti i tyre mund të çojë në kufizim të konkurrencës dhe në shkelje të nenit 9 të ligjit, i cili ndalon abuzimin e pozitës dominante në treg.

Nga ky monitorim, u identifikua mundësia që sjellja e ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptimin e nenit 9 të ligjit. Për këtë arsye, me Vendimin nr. 1173, datë 09.04.2025, Komisioni i Konkurrencës vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj këtyre ndërmarrjeve.

Gjatë hetimit paraprak, pas një analize të thelluar të fakteve dhe të dhënave të mbledhura, u konkludua se sjellja e këtyre ndërmarrjeve nuk përbënte asnjë nga format e abuzimit të parashikuara në nenin 9 të ligjit. Përkundrazi, aktivitetet e vëzhguara, si ofrimi i zbritjeve për pacientë të pasiguruar, fleksibiliteti në çmime për kategoritë më vulnerabël dhe bashkëpunimi me fonde publike shëndetësore si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, reflektojnë praktika që përputhen me përgjegjësinë sociale dhe konkurrencën e ndershme.

Në vlerësimin strukturor të tregut, nga ana e AK-së nuk u konstatuan barrierat konsiderueshme ligjore, administrative apo financiare që të pengonin hyrjen e ndërmarrjeve të tjera në tregun e shërbimit spitalor, duke garantuar kështu ekzistencën e presionit konkurrues nga operatorë të tjerë potencialë dhe aktualë.

Duke u mbështetur në mungesën e provave të mjaftueshme për të vërtetuar një shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1197, datë 21.07.2025, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve American Hospital SHA

dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor. Gjithashtu, u vendos që sjellja e këtyre ndërmarrjeve të monitorohet për një periudhë 1-vjeçare.

Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë të monitorojë tregun e shërbimit spitalor dhe nuk do të hezitojë të ndërmarrë hetime të reja në çdo rast kur të lindë indicie të bazuara për shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i transportit urban në Bashkinë Kamëz*

Pas ankesave të depozituara pranë AK dhe shqetësimeve të bëra publike në media, lidhur me rritjen e çmimeve të biletave dhe aboneve të transportit urban, AK nisi procedurën e monitorimit nga ku u konstatua se, ndërmarrja SHPRESA – AL SHPK ishte i vetmi operator i licencuar për ofrimin e shërbimit të transportit urban në këto linja, duke zotëruar pozitë dominuese në treg, në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003. Gjithashtu, nuk u administruan analiza të plota ekonomike apo financiare që të vërtetonin se rritja e tarifave mbështetej në rritje reale të kostove, ishte ekonomikisht e domosdoshme dhe e justifikuar mbi baza objektive të tregut.

Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1246, datë 12.12.2025 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 1 janar 2025 deri në 12 dhjetor 2025, dhe është në proces.

KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE

TRANSAKSIONE NË TREGUN E BRENDSHËM

AK KA AUTORIZUAR 30 TRANSAKSIONE NË TREGUN SHQIPTAR, TË CILAT JANË TË DETAJUARA SIPAS TREGJEVE PARAQITEN SI MË POSHTË:

**TREGUN E SHITJES ME SHUMICË DHE PAKICË TË PRODUKTEVE
USHQIMORE DHE INDUSTRIALE**

TREGU FARMACEUTIK

TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

TREGUN E SHËRBIMEVE

TREGUN E NDËRTIMIT DHE INFRASTRUKTURËS

TREGU I PAJISJEVE ELEKTRONIKE, SOFTWAREVE DHE LOJRAVE TË FATIT

TREGU I TELEKOMUNIKACIONIT, MEDIAS AUDIOVIZIVE

**AK KA AUTORIZUAR 28 TRANSAKSIONE TË REALIZUARA NË TREGUN E
JASHTËM**

Në nenin 10, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003, parashikohet se përqendrimet të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e:

- Bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra –tjetra;
- Përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose aseteve, kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm;
- Kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit.

Një përqendrim, bëhet objekt shqyrtimi nga ana e AK, nëse përmbushet edhe kufiri i xhiros së parashikuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003, ku parashikohet se “Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse, në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:

- xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar, është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse në


tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

- b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë”.

Gjatë vitit 2025 pranë AK janë njoftuar 71 transaksione, nga të cilat:


- 58 transaksione ka kaluar në procedurat e kontrollit të përqendrimeve dhe janë autorizuar nga KK në kuptim të nenit 56, pika 1 dhe nenit 57, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003.
- 13 transaksione nuk kanë plotësuar kriteret e ligjit dhe janë kualifikuar si vlerësime ligjore.

■ Transaksione te autorizuara ■ transaksione jashte objektit te ligjit




Referuar tregut, ku ushtronin aktivitet palët pjesëmarrëse në përqendrim, ka rezultuar se 30 nga transaksionet e autorizuar gjatë vitit 2025, kanë qenë transaksione të ndodhura në tregun e brendshëm dhe 28 transaksione në tregun ndërkombëtar.

Ndryshe nga gjithë historiku i përqendrimeve të vlerësuar nga AK, në vitin 2025, numri i rasteve të përqendrimeve në tregun e brendshëm është më i lartë se transaksionet në tregun e jashtëm.



Ky tregues ka ardhur si pasojë e ndërgjegjësimit të biznesit, nëpërmjet masave administrative, por edhe bashkëpunimit të AK me QKB, nëpërmjet mesazheve informuese, për shoqëritë që regjistrojnë ndryshime të kuotave/ aksioneve.

Tregjet më të prekura nga transaksionet gjatë vitit 2025 kanë qenë: tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë (produkte ushqimore, bujqësore, industriale, plehra kimike, etj), tregu i prodhimit të energjisë elektrike, tregu farmaceutik dhe tregu i shërbimeve (edukim; qira; akomodim).



Në nenin 73, pika 1 germa b) dhe dh) të ligjit nr. 9121/2003, është parashikuar që KK vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 përqind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse:

- japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;
- nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji (afati 30 ditor nga lidhja e kontratës/marrëveshjes).

Gjatë vitit 2025, KK ka marrë 3 vendime dhe ka vendosur 5 gjoba për shkelje të nenit 73, në vlerën totale 1.530.000 lekë dhe konkretisht:

- Vendimi nr. 1150, datë 14.01.2025 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë M42 LTD, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD”.
- vendimi nr. 1184, datë 05.06.2025, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët me funksione të plota, të shoqërisë INTER STOCK Albania SHPK”.
- vendimi nr. 1208, datë 27.08.2025 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK”, i ndryshuar.

2.5.1 Transaksione në tregun e brendshëm

AK ka autorizuar 30 transaksione të realizuara në tregun shqiptar, të cilat të detajuara sipas tregjeve paraqiten si më poshtë:

➤ ***Tregtimi me shumicë dhe pakicë (produkte ushqimore, bujqësore, industriale, plehra kimike)***

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 9 transaksione, të cilat janë grupuar sipas palëve të përfshira në transaksion:

1. *Përftimi i kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.*

Pranë AK u njoftua transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.

Tregu përkatës në këtë transaksion, u konsiderua tregu i shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe produkteve jo ushqimore.

Pas analizës së konkurrencës dhe bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121/2003, KK me vendimin nr.1177, datë 24.04.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK”, gjykoi të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e njoftimit mbi finalizimin përfundimtar të transaksionit të realizuar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

Pas njoftimit të AK për finalizimin përfundimtar të këtij transaksioni, Sekretariati, bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121/2003, realizoi procedurën e kontrollit të përqendrimeve.

Transaksioni i njoftuar u klasifikuar si një përqendrim konglomerat pasi palët në transaksion, Viva Fresh dhe SPAR, nuk operonin në të njëjtin treg përkatës gjeografik.

Shoqëria Viva Fresh SHPK ishte aktive në shitjen me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore në tregun e Kosovës. Në Shqipëri, Viva Fresh ishte prezent nëpërmjet filialit të saj “VIVA FRESH” SHPK dhe kishte realizuar të ardhura vetëm nëpërmjet qiradhënies së hapësirave të saj për ambiente zyresh dhe magazina.

Shoqëria Spar Albania SHPK ishte një shoqëri, e cila operonte përmes rrjetit të saj të marketeve, supermarketeve dhe hipermarketeve nën markën ndërkombëtare “SPAR”.

Nga analiza e konkurrencës u konstatua se përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje midis aktiviteteve të palëve (blerës dhe target) në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshime dhe nuk do të kishte ndikim në strukturat e tregut.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1200, datë 25.07.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK”, autorizoi përfundimisht transaksionin e njoftuar.

2. *Përftimi i kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1189, datë 26.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar, të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes me pakicë të produkteve tekstile dhe të modës, përfshirë veshjet, këpucët dhe aksesorët.

Shoqëria Fashion Group Albania SHPK operonte në Shqipëri përmes rrjetit të saj të dyqaneve nën markat ndërkombëtare “Aldo”, “Carpisa”, “Cortefiel”, “Geox”, “Mango”, “Okaidi”,

“Parfois”, “Prenatal”, “Springfield”, “Eoman Secrets” (“Markat Ndërkombëtare”).

Shoqëria blerëse, ALBI HOLDING SHPK është pjesë e Albi Group, i cili zotëron një rrjet dyqanesh me produkte të modës, që operojnë në Kosovë dhe rajon, duke përfaqësuar markat ndërkombëtare si Celio, Chaussea, Okaidi, Mango, Springfield, Ozdilek, Geox, Gant, Timberland, Hugo Boss, Sportina Armani Exchange, Tom Tailor, XYZ, UGG, Plein Sport, Orsay, Dan John, Parfois, Boggi.

Edhe pse ALBI HOLDING SHPK, si pjesë e Albi Group, dhe Fashion Group Albania SHPK operojnë në të njëjtin treg përkatës produkti, transaksioni nuk do të sillte ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri pasi Albi Group ishte aktiv vetëm në Kosovë, ndërsa FGA është aktiv vetëm në Shqipëri.

Për këto arsye, KK autorizoi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK.

3. Krijimi i shoqërisë Just Fun Balkans SHPK dhe shoqërisë Just Fun Distribution SHPK

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr.1207, datë 27.08.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nga krijimi i shoqërisë Just Fun Balkans SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shpërndarjes me shumicë dhe shitjes me pakicë të produkteve të konsumit të përditshëm jo-ushqimore të markës “Flying Tiger Copenhagen”.

Palët në transaksion ushtronin aktivitet në tregje të ndryshme dhe vetëm Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK kishte aktivitet në territorin vendas.

Shoqëria franshizëmarrëse Just Fun Balkans SHPK do të operonte në tregun e shitjes me pakicë të produkteve të konsumit të përditshëm të markës “Flying Tiger Copenhagen”, nëpërmjet dyqaneve të konceptuara dhe operuara nga ku përfshihen produkte të tilla si artikuj dekorativ për shtëpi, lodra, produkte sezonale dhe artikuj të stilit të jetesës.

Shoqëria Just Fun Distribution SHPK do të operonte në tregun e shpërndarjes me shumicë të produkteve të konsumit të përditshëm të markës “Flying Tiger Copenhagen”, i cili përfshin veprimtarinë e importit, magazinimit dhe shpërndarjes. Shoqëria Just Fun Distribution SHPK do të operojë në mbështetje të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK.

Nga analiza u konstatua se krijimi i dy shoqërive të reja, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK do të siguronte hyrjen e dy ndërmarrjeve konkurruese në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të konsumit të përditshëm jo-ushqimore, si dhe futjen në treg të një marke të re ndërkombëtare “Flying Tiger Copenhagen”, duke zgjeruar zgjedhjen konsumatore.

Për këto arsye, KK autorizoi krijimin e shoqërive Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK.

4. Përftimi i kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria EUROLAB INTERNACIONAL GRUP SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1154, datë 29.01.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA

nga shoqëria EUROLAB INTERNACIONAL GRUP SHPK”.

Tregu përkatës, në këtë transaksion, u konsiderua tregu i shitjes së birrës.

Shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK ushtronte aktivitet në importin, eksportin, tranzitimin dhe tregtimin e mallrave të ndryshme industriale, shitjen, distribucionin direkt, marketingun dhe furnizimin e klientëve me produkte ushqimore të gatshme dhe pije alkoolike.

Shoqëria Target, STEFANI & CO SHA ushtronte aktivitetin në prodhimin e tregtimin me shumicë e pakicë të artikullit të birrës e pijeve alkoolike e joalkoolike, ujit mineral natyral dhe ujit natyral me gaz karbonik të shtuar etj.

Transaksioni i njoftuar u klasifikua si përqendrim horizontal me efekte në tregun e shitjes me shumicë të birrës.

Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se tregu i birrës karakterizohej nga një numër i madh ndërmarrjesh dhe një numër i konsiderueshëm markash tregtare. Tregu paraqet një stabilitet të pjesëve të tregut dhe renditjes së ndërmarrjeve kryesore në treg, por vetëm njëra prej tyre, TABBACO HOLDING SHPK kishte ekskluzivitetin e shitjes së një marke të caktuar (birra Peja), markat e tjera kishin disa ofrues (ndërmarrje tregtare). Gjithashtu u konstatua se disa nga ndërmarrjet importuese operonin në tregun e shitjes me pakicë të produkteve ushqimore, duke u integruar vertikalisht në tregtimin e birrës.

Transaksioni i njoftuar nuk pritej të kishte ndonjë efekt të mundshëm koordinimi për momentin.

Përqendrimi do të krijonte mbivendosje të aktivitetit të palëve në nivel kombëtar, por pa shfaqur shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA.

5. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, INTER STOCK Albania SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK”.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1183, datë 05.06. 2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, INTER STOCK Albania SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës.

Nga analiza e konkurrencës u evidentua se shoqëria AGNA SHA realizonte pjesën më të madhe të të ardhurave nga aktivitetet e tregtimit të cigareve, mallrave ushqimore dhe jo ushqimor etj dhe nuk ushtronte aktivitet në tregun përkatës të prekur nga transaksioni.

Shoqëria INTER STOCK SHPK, ishte një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës dhe nuk zotëronte ndonjë filial/ degë në Shqipëri.

Krijimi i ndërmarrjes së përbashkët kishte si qëllim hapjen e dyqaneve të specializuara për shitjen e veshjeve, të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, duke mundësuar hyrjen e një konkurrenti të ri në treg.

Tregu i shitjes me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, karakterizohet nga një numër i madh

ofruesish, numër i madh produktesh me dhe pa markë, dhe krijimi i ndërmarrjes së përbashkët INTER STOCK Albania SHPK nuk pritej të krijonte shqetësime për konkurrencën nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës të produktit në Shqipëri.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë krijimin e ndërmarrjes së përbashkët INTER STOCK Albania SHPK.

6. Përfitim i kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1222, datë 29.10.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK”.

Treg përkatës i produktit në këtë transaksion u konsiderua tregu i restoranteve me shërbim të shpejtë (fast-food).

Shoqëritë Fast Food Albania SHPK dhe KAN ALBANIA SHPK ishin shoqëri të krijuara për qëllime të këtij transaksioni.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria Fast Food Albania SHPK do të ishte zotëruese e biznesit markës KFC në Shqipëri, që përfshin të gjitha kontratat e nevojshme për ushtrimin e biznesit KFC (marrëveshjet e franshizës etj.) dhe punonjësit e nevojshëm për ushtrimin e këtij biznesi.

Ndërkohë shoqëria KAN ALBANIA SHPK zotërohet nga KAN SH.P.K., një shoqëri kosovare, e cila ushtron aktivitetin e KFC-së në Kosovë.

Nga analiza e konkurrencës u evidentua se futja e një konkurrenti të ri në treg, duke marrë parasysh eksperiencën shumë vjeçare të Grupit të Blerësit në Kosovë nën të njëjtën markë tregtare, do të shtojë më tej konkurrencën në treg dhe do të përmirësojë standardet e shërbimit në përfitim të konsumatorit.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK.

Tregu i prodhimit të materialeve ushtarake

AK u njoftua për 3 transaksione, të cilat konsistojnë në krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta (publik-privat) dhe që do të ndikojnë në tregun e prodhimit dhe furnizimit me materiale ushtarake; arme, veshje/aksesore dhe automjete ushtarake.

7. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, TIMAK DEFENCE SHA

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1219, datë 10.10.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA, nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe furnizimit të automjeteve motorike të posaçme, të blinduara ushtarake, për përdorim institucional (nga Forcat e Armatosura, policia, agjencitë e emergjencave, etj.).

Palët në transaksion, shoqëria KAYO SHA kishte objekt aktiviteti projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e

komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake, ndërkohë që aktiviteti ekonomik i TIMAK SHPK ka qenë i fokusuar në prodhimin/përshtatjen e komponentëve dhe konstruksioneve për makina të ndryshme ose përshtatjen/riparimin e mjeteve të veçanta (përfshirë mjete komerciale ose speciale civile) dhe, në raste të caktuara, importin/furnizimin e mjeteve të posaçme (p.sh. ambulanca, kamionë zjarrfikës, automjete logjistike) përmes kontratave tregtare.

Ndërmarrja e përbashkët TIMAK DEFENCE SHA do të operonte në prodhimin ose përshtatjen e mjeteve motorike të posaçme, me një arkitekturë të hapur që lejon instalimin e sistemeve të armatimit, siç janë armët automatike, sistemet e artilerisë, etj.

Nga analiza, u evidentua se krijimi i shoqërisë TIMAK DEFENCE SHA pritet të shtojë kapacitete të reja prodhuese vendase në industrinë e mbrojtjes, pa shkaktuar efekte negative në konkurrencë.

Për këto arsye, KK vendosi autorizimin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët TIMAK DEFENCE SHA.

8. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, M.K.D SHA.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1220, datë 10.10.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu për prodhimin dhe tregtimin e municioneve të kalibrave të vegjël dhe të mesëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe strukturat e tjera të sigurisë.

Nga analiza u evidentua se ndërmarrjet mëma nuk janë aktive në të njëjtin treg produkti, e për rrjedhojë nuk ka asnjë bazë për të konsideruar se krijimi i M.K.D SHA do të shkaktojë koordinim të sjelljes konkurruese midis MSSC dhe KAYO. Ndërmarrja e përbashkët u krijua me qëllim kombinimin e përpjekjeve komplementare të palëve (kapital shtetëror dhe privat) në një veprimtari të re prodhuese, dhe nuk do të lehtësojë asnjë shkëmbim informacioni apo marrëveshje të fshehtë ndërmjet palëve në ndonjë treg tjetër.

Për këto arsye, KK vendosi autorizimin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët *M.K.D SHA*.

9. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GUNA TACTICAL SHA.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1220, datë 10.10.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit dhe furnizimit të uniformave dhe aksesorëve ushtarakë për forcat e armatosura dhe struktura të tjera të sigurisë.

Nga vlerësimi i dokumentacionit u evidentua se shoqëria KAYO nuk ka operuar në tregun e uniformave apo pajisjeve të tekstilit ushtarak. Shoqëria MSSC ka qenë importues dhe furnizues i uniformave të gatshme dhe aksesorëve ushtarakë, por nuk ka zhvilluar veprimtari prodhuese në këtë sektor në Shqipëri, duke mos qenë aktiv në të njëjtin treg të produktit si ndërmarrja e përbashkët. Roli i saj ka qenë ekskluzivisht si distributor dhe jo si prodhues i uniformave.

Asnjëra nga shoqëritë mëmë, MSSC dhe KAYO, nuk ka operuar në të njëjtin treg me

ndërmarrjen e përbashkët GUNA TACTICAL dhe nuk zhvillojnë veprimtari në tregje të afërta. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi autorizimin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët *GUNA TACTICAL SHA*

➤ ***Sektori i ndërtimit dhe infrastrukturës.***

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 5 transaksione. Nga vlerësimi i rasteve është konstatuar se transaksionet kanë qenë përqendrimet konglomerate dhe kanë patur si qëllim zhvillim projekteve ndërtimore në fushën e hotelierisë dhe në rezidencat e banimit.

1. *Përfitim i kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK nga Z. Aleksandër Frangaj”.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1174, datë 09.04.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK nga Z. Aleksandër Frangaj”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të akomodimit nga hotelet me 4 dhe 5 yje dhe resortet.

Transaksioni u klasifikua si një përqendrim konglomerat dhe shoqëria target u evidentua të ishte në fazën e zhvillimit të projektit të investimit të një resorti turistik, i cili do të përfshijë ndërtimin e një hoteli, njësi për biznes dhe evente, sera me lule, ambiente sportive, hapësira për fëmijë, SPA, beach bar, kazino dhe njësi të tjera shërbimi në zonën e Gjilekës, Bashkia Himarë.

Nga analiza i konstatua se transaksioni nuk do të sillte mbivendosje të aktiviteteve të palëve dhe për pasojë nuk kufizonte konkurrencën në tregun përkatës.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK.

2. *Përfitim i kontrollit të përbashkët indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK”.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1198, datë 25.07.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar, për përfitim të kontrollit të përbashkët indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ndërtimit dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme për përdorim komercial në zhvillimin e projekteve të parqeve tregtare dhe krijimi i infrastrukturës për ofrimin e hapësirave me qira për aktivitete të shitjes me pakicë.

Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një grup i diversifikuar investimesh, i angazhuar kryesisht në shitjen me pakicë, pasuritë e paluajtshme, veprimtarinë minerare dhe shërbimet bankare dhe shoqëria CEE – BIG B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përfaqëson degën evropiane të grupit izraelit BIG Shopping Centers Ltd. Për CEE – BIG B.V.

Shoqëria Retail Park Shkodra SHPK u themelua për qëllimin specifik të zhvillimit, menaxhimit dhe operimit të një parku tregtar në qytetin e Shkodrës, si pjesë e një programi më të gjerë investimesh në infrastrukturën komerciale në Shqipëri, për zhvillimin dhe dhënien me qira të hapësirave për shitje me pakicë dhe shërbime komerciale në një format të konceptuar si retail park.

Nga aspekti vertikal, Balfin do të angazhohet në zhvillimin dhe ndërtimin e projekteve të retail park-ut dhe gjithashtu në administrimin e disa prej aseteve fillestare, ndërsa BIG pritej të fokusohet kryesisht në menaxhimin dhe operimin e tyre pas ndërtimit sipas praktikës dhe ekspertizës së saj ndërkombëtare, pa patur marrëdhënie si furnitor-klient.

Nga analiza u konstatua se përqendrim nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe transaksioni nuk do të sillte ndryshime në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK

3. Përftimi i kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1229, datë 18.11.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK”

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua i ndërtimit të rezidencave të banimit dhe shërbimit.

Transaksioni i njoftuar u klasifikua si përqendrim konglomerat pasi shoqëria QUMESHTI AJKA SHA ushtronte aktivitetin e grumbullit dhe përpunimit të qumështit dhe i nënprodukteve të tij, import eksport lëndësh të para ndihmëse dhe produkteve të gatshme, tregtimi i produkteve ushqimore, por e pezulluar prej disa vitesh.

Shoqëria SAIMBEI SHPK operonte në tregun e import- eksport, tregti cigaresh dhe artikuj të ndryshëm, si dhe ishte pajisur me Licence Profesionale të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Nëpërmjet transaksionit, shoqëria SAIMBEI SHPK do të bëhej përfitues i kontrollit dhe për pasojë i aseteve të targetit dhe kishte për qëllim pjesëmarrje në zhvillimin e projekteve ndërtimore në rrugën 5 Maji, Tiranë (mbi asetet e targetit).

Nga analiza u konstatua se transaksioni i propozuar nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe nuk do të ndikonte në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të palëve pjesëmarrëse në transaksion.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA.

4. Përftimi i kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1204, datë 27.08.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ndërtimit, duke përfshirë ndërtim linjash

elektrike, rrugë, godina, ujësjellës- kanalizime.

Shoqëria 4 A-M SHPK, kishte aktivitet kryesor: punime & instalime elektrike, tregtim imp-exp materialesh, ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj

Shoqëria target, ILIRIADA SHPK, ushtronte aktivitetin në tregun e ndërtimit të linjave elektrike, rrugë, godina, ujësjellës- kanalizime.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, duke krijuar mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun e ndërtimit, ndërtim linjash elektrike, rrugë, godina, ujësjellës- kanalizime, pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në të njëjtin treg produkti.

Referuar pjesës së tregut të palëve pjesëmarrëse në transaksion, u konstatua se pjesa e vogël e tregut e shoqërisë target pritej që të mos ndikonte në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të shoqërisë 4 A-M SHPK.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK.

5. Përftimi i kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1223, datë 29.10.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfkrimin e kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ndërtimit, duke përfshirë ndërtim, rikonstrukcion dhe mirëmbajtje objekte banimi, shërbimi, hoteleri në funksion të turizmit.

Shoqëria target, HEAVEN BEACH SHPK, ishte një shoqëri e re, e cila kishte objekt aktivitetin në tregun e ndërtimit duke përfshirë ndërtim, rikonstrukcion dhe mirëmbajtje objekte banimi, shërbimi, hoteleri në funksion të turizmit, por e fokusuar aktualisht në zhvillimin e kapitalit të shoqërisë, hoteli në Çukë, në Sarandë.

Shoqëria blerëse operonte në tregun e punime & instalime elektrike, tregtim imp-exp materialesh, ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj dhe nëpërmjet këtij transaksioni synonte të investonte në fushën e turizmit (mbi asetet e targetit), duke sjellë përmirësim të infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve të shërbimeve në ndërtim dhe turizëm.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK.

➤ Tregu farmaceutik.

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 4 transaksione, të cilat janë si më poshtë:

1. Përftimi i kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK”.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1161 datë 13.02.2025 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfkrimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së barnave dhe produkteve

farmaceutike.

Nga analiza e realizuar u konstatua se pala blerëse, DELTA HOLDING SHPK, ishte një shoqëri holding, por nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, operonte në tregun e importit eksportit, tregtimit me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore, barnave popullore, pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, mjeteve dhe materialeve ndihmëse mjekësore etj.

Shoqëria Target, DELTA Med SHPK ushtronte aktivitet në tregtim të artikujve farmaceutikë dhe kozmetikë, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji.

Transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim vertikal, pasi pala blerëse, DELTA HOLDING SHPK, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, ushtronte aktivitetin në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutikë, si depo primare dhe farmaci, ndërkohë që shoqëria target DELTA Med SHPK, operonte në tregun e shitjes me shumicë, si depo sekondare.

Treguesit e përqendrimit të tregut para dhe pas përqendrimit nuk shfaqën shqetësime për konkurrencën, nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK.

2. Përfitim i kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. nr. 1179, datë 14.05.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes me pakicë të barnave dhe produkteve farmaceutike.

Nga analiza e konkurrencës u konstatua se si aktiviteti i rrjetit të “Farma Net Albania”, ashtu edhe pala blerëse, shoqëria DITË E NATË SHPK, ishin të pajisura me licencë për tregtim me pakicë të barnave, për këto arsye, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, pasi pala blerëse dhe biznesi target ushtrojnë aktivitet në tregun e shitjes me pakicë të produkteve farmaceutikë si farmaci.

Tregu i shitjes me pakicë të barnave dhe produkteve farmaceutike paraqitej si një treg jo i përqendruar, me tregues të ulët të indeksit të përqendrimit HHI, asnjë prej ndërmarrjeve nuk kishte pjesë të mëdha tregu duke mos evidentuar një pozicion dominues në treg dhe për shkak të numrit të madh të ndërmarrjeve që operojnë në të, produktet farmaceutike janë lehtësisht të zëvendësueshme nga ana e ofertës.

AK vlerësoi se transaksioni i blerjes së Veprimtarisë Ekonomike të njësive farmaceutike nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK, nuk pritej të sillte kufizime të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK.

3. Përfitim i kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga Z. Klodian Allajbeu”.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1180, datë 14.05.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga Z. Klodian Allajbeu”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se shoqëria target, Med Lab SHPK nuk kishte realizuar importe dhe as shitje të produktit të tregut përkatës gjatë viteve 2023-2024, ndërkohë që shoqëritë e kontrolluara indirekt nga z. Allajbeu, AMERICAN HOSPITAL SHA, International Hospital SHA dhe PHARMA ONE SHPK, zotëronin së bashku një pjesë shumë të vogël të importeve të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Transaksioni u klasifikua si një përqendrim horizontal në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Nga analiza e konkurrencës u konstatua se përfimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë Med Lab SHPK nga z. Allajbeu nuk do të ndikonte në strukturën e tregut dhe nuk do të shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës.

Nga të dhënat e administruara, u evidentua se shoqëritë e kontrolluara indirekt nga z. Allajbeu ushtronin aktivitet në tregun e shërbimit spitalor. Gjithashtu, shoqëria target, Med Lab SHPK, pavarësisht mos kryerjes së aktivitetit ekonomik, zotëronte kontroll të përbashkët mbi shoqërinë PHARMA ONE SHPK së bashku me shoqërinë EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK, shoqëri të cilat ushtronin aktivitet në tregun e tregtimit të produkteve farmaceutike.

Për shkak të natyrës së aktivitetit, shërbimi spitalor dhe tregtimi i produkteve farmaceutike konsiderohen si tregje të lidhura për shkak të marrëdhënies tregtare, klient-furnitor.

Transaksioni i njoftuar kishte efekte në tregje të lidhura, pasi shoqëria target, Med Lab SHPK ishte një shoqëri që ushtronte aktivitetin në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike si dhe në tregun e shitjes së produkteve farmaceutike, ndërsa pala blerëse, z. Klodian Allajbeu zotëronte kuota në shoqëri që kishin aktivitet në tregje të ndryshme nga tregu përkatës i produktit.

Kombinimi i produkteve në tregjet e lidhura, mund t'i jepte shoqërive të kontrolluara nga blerësi mundësinë dhe ta nxiste që të transmetonte një pozicion tregu të fuqishëm nga një treg në një tjetër me anë të praktikave kushtëzuese ose praktikave të tjera përjashtuese.

Nga analiza e kryer, u vlerësua se transaksioni nuk pritej të sillte efekte antikonkurruese as në tregjet e lidhura me transaksionin.

Duke qenë se shoqëria target nuk kishte ushtruar aktivitet dhe nuk kishte realizuar të ardhura në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike, pritej që transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë target nga z. Klodian Allajbeu nuk do të ndikonte në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të saj në tregun përkatës të produktit.

Transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga z. Klodian Allajbeu nuk pritej të kufizonte konkurrencën në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Shqipëri dhe as në tregjet e lidhura me transaksionin.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të

kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK.

4. *Përfitim i kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK* ”.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1232, datë 26.11.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua i shitjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Mbështetur në të dhënat e administruara, DIAL-AL SHPK dhe EVITA SHPK janë importues së pajisjeve mjekësore dhe laboratorike dhe transaksioni i përfitimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK, krijonte një mbivendosje horizontale në tregun e shitjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore.

Nga vlerësimi i strukturës së tregut përkatës të produktit u konstatua se palët pjesëmarrëse në transaksion, shoqëria Evita SHPK dhe DIAL-ALB SHPK, kanë realizuar importe në vlera të ulta dhe për më tepër, në tregun e shitjes së materialeve mjekësore dhe laboratorike, shoqëria target zotëron një pjesë shumë të vogël në treg.

Për sa më sipër, përfitimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga Evita SHPK nuk pritet të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të palëve pjesëmarrëse në transaksion, në tregun përkatës të produktit.

Për këto arsye, KK autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK.

➤ *Tregu i prodhimit dhe shitjes së energjisë elektrike.*

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 3 transaksione, të cilat janë si më poshtë:

1. *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1162 datë 07.03.2025 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë palë në transaksion, vetë ose nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej tyre, kishin si objekt aktiviteti prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme. Disa prej tyre ishin në fazën e zbatimit të projekteve të ndërtimit të impianteve prodhuese ose ishin të pajisura me licencat përkatëse për prodhimin e energjisë elektrike.

Transaksioni i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, e cila pritej të ishte aktive në tregun e energjisë elektrike (në prodhimin e energjisë), do të sillte përfitime për konkurrencën pasi do të mundësonte hyrjen e një konkurrenti të ri në treg.

Përqendrimi do të krijonte mbivendosje midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, por pa shfaqur shqetësime për konkurrencën në treg.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, Seman Sunpower SHPK dhe Albanian General Electricity SHA.

2. Përfitim i kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1186, datë 26.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Përfitimi i kontrollit të shoqërisë target, MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK, do të krijonte një mbivendosje të aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim horizontal në këtë treg.

Nga dokumentacioni i administruar, u konstatua se shoqëria MD green energy SHPK nuk ushtronte aktivitet dhe nuk kishte realizuar të ardhura në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, shoqëria e kontrolluar nga 4 A-M SHPK, GREEN ENERGY PLUS SHPK, nuk ka patur aktivitet në tregun përkatës dhe për këto arsye, pritej që transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK nuk do të sillte ndryshime në tregun përkatës të produktit, pasi nuk kishte ndryshim (zvogëlim) të numrit të konkurrentëve në tregun përkatës dhe as rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjes si rrjedhojë e realizimit të përqendrimit.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK.

3. Përfitim i kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG Power SHPK nga shoqëritë SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A..

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1210, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG Power SHPK nga shoqëritë SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A.”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i furnizimit me energji elektrike.

Shoqëria SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. është e regjistruar në shtetin grek dhe nuk kishte gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

Shoqëria DEPA Commercial S.A., paraqitej aktive në tregun e furnizimit, shitjes me shumicë dhe tregtimin e gazit natyror, si dhe në furnizimin me pakicë të energjisë elektrike dhe kishte realizuar të ardhura nga eksporti i energjisë elektrike në Shqipëri. Referuara volumit të sasisë së eksportuar në Shqipëri, rezultonte se kjo shoqëri ka mbuluar një pjesë shumë të vogël të volumit të importeve të realizuar nga sistemi energjetik shqiptar.

DEPA Commercial S.A. kontrollon shoqërinë FIER Thermoelectric SHA, shoqëri e themeluar me qëllimin e ndërtimit të TEC me fuqi prej rreth 170MW në Roskovec, që do të lidhet me sistemin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline AG. Ndërtimi i TEC është ende në

fazën e projektimit.

Shoqëria target, NRG Power SHPK, ishte licencuar nga ERE në furnizimin me energji elektrike, por nuk ka kryer aktivitet dhe nuk ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2024.

Nëpërmjet këtij transaksioni palët synojnë zgjerimi i aktivitetit të tyre në sektorin e furnizimit të energjisë elektrike jashtë Greqisë si dhe zgjerimi në fushën e furnizimit me energji elektrike në Shqipëri.

Transaksioni i njoftuar nuk do të krijonte mbivendosje horizontale apo vertikale midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në strukturat e tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG Power SHPK.

➤ ***Tregu i shërbimeve (edukim, qeradhënie, akomodim).***

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 3 transaksione, të cilët janë si më poshtë:

1. *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimin e 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.*”

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr.1160, datë 13.02.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimin e 40% të aksioneve të shoqërisë Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua (i) tregu i menaxhimit dhe operimit të qendrave argëtuese dhe (ii) tregu i teknologjive të argëtimit.

Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK ishte një grup i diversifikuar investimesh, i angazhuar kryesisht në shitjen me pakicë, pasuritë e paluajtshme, veprimtarinë minerare dhe shërbimet bankare. Shoqëria Fundëay L.L.C. përfshinte pronësinë e disa kompanive lider në industri të ndryshme, duke filluar nga sigurimet, argëtimi familjar, ndërtimi dhe teknologjia etj.

Ky transaksion do të mundësonte shkëmbimin e njohurive ndërmjet Fundëay dhe Balfin, duke optimizuar operacionet dhe duke përmirësuar konkurrencën e përgjithshme në tregun e argëtimit.

Transaksioni i propozuar nuk do të sillte ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe nuk do të sillte ndryshime dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe Fundway L.L.C. dhe transferimi i 40% të aksioneve të shoqërisë

Unlimited Gaming SH.P.K. nga shoqëria Fundway L.L.C. tek shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

2. Përftimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.”

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1176, datë 24. 04.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.”

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua sektori i arsimit të lartë jopublik.

Përqendrimi u realizua nëpërmjet ndryshimit të Statutit të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, e cila solli për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë.

Duke marrë parasysh pjesën e vogël të tregut të TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK në sektorin e arsimit të lartë jopublik, transaksioni i njoftuar nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, pasi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

3. Përftimi i kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1185, datë 05.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK”.

Treg përkatës në transaksionin e njoftuar u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore.

Përftimi i kontrollit indirekt të shoqërisë target, ECO RICIKLIM SHPK nga z. Allajbeu, nëpërmjet shoqërisë ANAMARK SHPK, do të krijonte një mbivendosje me aktivitetin e shoqërisë MEDICAL RECYCLING SHPK, shoqëri e zotëruar nga z. Klodian Allajbeu, në tregun e ofrimit të shërbimit pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim horizontal në këtë treg.

Nga dokumentacioni i administruar, u konstatua se shoqëria MEDICAL RECYCLING SHPK nuk ushtronte aktivitet prej shumë vitesh dhe nuk kishte realizuar të ardhura në tregun e ofrimit të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, dhe për këto arsye, pritej që transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK nuk do të sillte ndryshime në tregun përkatës të produktit, pasi nuk kishte ndryshim (zvogëlim) të numrit të konkurrentëve dhe as rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjes si rrjedhojë e realizimit të përqendrimit.

Ky përqendrim nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK.

➤ **Tregu i sigurimeve.**

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 2 transaksione, të cilat janë si më poshtë:

1. *Përftimi i kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1157, datë 05.02.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA nga shoqëria SIGAL BUSINESS CENTER SHPK.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i sigurimit (sigurimi i jetës dhe i jo-jetës).

Aktiviteti që kryente SIGAL BUSINESS CENTER SHPK shtrihej më së shumti në investimet e kapitalit dhe burimeve të tjera financiare, blerje apo shitje e të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe dhënia me qira e pasurive (pavarësisht se objekti i veprimtarisë së saj ishte më i gjerë, ku përfshiheshin dhe aktivitetet e import – eksport të të gjitha llojeve të mallrave, shërbime konsulence, etj.).

Shoqëria target, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA ishte një shoqëri që ushtronte aktivitetin në tregun e sigurimit të jo-jetës dhe nëpërmjet shoqërisë SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SHA edhe në tregun e sigurimit të jetës.

Transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim konglomerat, pasi ndërmarrjet që merrnin pjesë në përqendrim nuk kishin as marrëdhënie horizontale (si konkurrentë në të njëjtin treg përkatës) dhe as vertikale (si prodhues edhe klientë). Palët në transaksion operonin në tregje të ndryshme.

Përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshime dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA.

2. *Përftimi i kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1181, datë 05.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i qirasë financiare.

Shoqëria UNION BANK SHA, përmes shoqërisë që zotëronte LANDESLEASE SHA, ofronte produkte të qirasë financiare. ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK ishte një shoqëri e licencuar nga Banka e Shqipërisë si Institucion Financiar JoBankë për të ofruar veprimtari të qirasë financiare.

Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim horizontal.

Referuar indekseve të përqendrimit të tregut, Herfindahl- Hirschman HHI, u konstatua se tregu i qirasë financiare kishte karakteristikat e një tregu të përqendruar ku indeksi HHI është mbi 2000,

si para dhe pas transaksionit dhe delta HHI është 292.

Referuar marrëveshjes së lidhur mes palëve, subjektet LANDESLEASE SHA dhe ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK do të vazhdonin të qëndronin si entitete të ndara. Blerja e shoqërisë target paraqitej si një mundësi për blerësin për të zgjeruar veprimtarinë në segmentet e mikrokredisë dhe huadhënies për konsumatorët pasi shoqëria target ishte e licensuar për ofrimin e produkteve të tilla. Fokusi i palës blerëse është orientimi i aktivitetit të targetit drejt tregut të kredidhënies, përmes një institucioni të dedikuar dhe të strukturuar posaçërisht për këtë klientelë pas konsolidimit të strukturës menaxheriale, operacionale dhe teknologjike të shoqërisë target.

Nga analiza u konstatua se ky përqendrim nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK dhe mbajtjen në monitorim të tregut të qirasë financiare nga IFJB për një periudhë 1 vjeçare nga dhënia e autorizimit.

➤ ***Tregu i pajisjeve elektronike, software dhe lojra fati.***

Në këtë treg, kanë kaluar në procedurat e kontrollit dhe janë autorizuar 2 transaksione, të cilat janë si më poshtë:

1. *Përftimi i kontrollit, nëpërmjet blerjes së kapitalit, në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1195, datë 21.07.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së kapitalit, në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i zgjidhjeve software-ike.

Nga vlerësimi i informacionit të administruar, u konstatua se shoqëria INFOSOFT SYSTEM SHPK është një nga shoqëritë kryesore në tregun e shitje së hardëare-ve dhe pajisjeve të lidhura me to, por pa evidentuar pjesë të konsiderueshme në treg. Ky treg karakterizohet nga një numër i madh ndërmarrjesh dhe më indekse të ulëta të përqendrimit të tregut.

Transaksioni i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Infosoft Business Solutions SHPK, nuk pritej të kishte për pasojë ndryshimin e strukturës të tregut të lidhur, pasi palët blerëse kanë qenë ortak kontrollues, direkt/indirekt, edhe më parë në kuotat e shoqërisë INFOSOFT SYSTEM SHPK. Për pasojë struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar edhe pas realizimit të përqendrimit.

KK vlerësoi se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK.

2. *Përftimi i kontrollit të shoqërisë Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1228, datë 18.11.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Space+ SHA nga shoqëria

GLG INVESTMENT SHPK”

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të aktiviteteve të lojërave të fatit në kategorinë kazino në hotel me 5 yje.

Shoqëria GLG INVESTMENT SHPK ishte një shoqëri e re, për të funksionuar si shoqëri holding dhe si e tillë nuk kishte realizuar të ardhura.

Shoqëria target, Space+ SHA ushtronte veprimtari në fushën e lojërave të fatit, pranë Hotel Marriot, dhe është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF).

Transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim konglomerat, pasi pala blerëse dhe targeti operonin në tregje të ndryshme. Për më tepër pala blerëse ishte një shoqëri holding dhe përfitimi i kontrollit mbi shoqërinë SPACE + nuk do të kishte për pasojë ndryshimin në strukturat e tregut.

Transaksioni i propozuar do të realizohej nëpërmjet futjes së një aseti, tokë, në kapitalin e shoqërisë target dhe sipas deklaratë së palës, transaksioni kishte për qëllim rritjen e biznesit dhe zgjerimin e fushës së investimeve të shoqërisë GLG INVESTMENT SHPK në tregun shqiptar.

Përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për këto arsye KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Space+ SHA.

➤ *Tregu i medias audiovizive.*

Në këtë treg, ka kaluar në procedurat e kontrollit dhe është autorizuar 1 transaksione:

1. Përfitimi i kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u njoftua ndryshimi i kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video.

Shoqëria Vertex Holding SHPK ishte një shoqëri e krijuar rishtazi për të funksionuar si shoqëri holding. Ortaku i shoqërisë Vertex Holding SHPK, z. Shalaj, ishte përfitues fundor në shoqëritë Artmotion SHPK dhe EUROLAB SHPK, në Kosovë.

Tring Tv SHA operonte në tregun e televizionit me pagesë si (i) një operator distributor paketash me kanale (ii) një operator editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira), (iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit numerik dhe rrjetit satelitor, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit kabllor dhe IPTV-së. Pra, Tring transmeton përmbajtjet televizive me pagesë mbështetur në frekuenca ashtu edhe mbështetur në rrjet komunikimi elektronik (kabëll ose IPTV). Tring Tv SHA ka në kanalet e saj operatorin kombëtar Vizion Plus.

Nga analiza e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës dhe kërkesës u konstatua se në tregun përkatës të produktit operonin 2 shoqëri, nëpërmjet paketave Tring dhe Digitalb me pagese, të cilët ofrojnë njëkohësisht (i) distribuim paketash me kanale; (ii) editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira), (iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale; si dhe (iv) transmetues nëpërmjet rrjetit të tyre numerik me shtrirje kombëtare, si dhe nëpërmjet rrjetit satelitor.

KK, pas shqyrtimit të raportit të paraqitur nga Sekretariati konstatoi se: nisur nga struktura e tregut përkatës, mungesa e një informacioni të plotë për të vlerësuar mundësinë reale të blerësit për të ushtruar aftësitë funksionale dhe për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target dhe me qëllim vlerësimin e efekteve të transaksionit mbi konkurrencën në treg, kërkohet një analizë më të thelluar e ndikimit dhe pasojave në tregun përkatës të produktit.

Për këto arsye, me vendimin nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”, KK vendosi fillimin e procedurës së thelluar të kontrollit të përqendrimit.

Në përfundim të procedurës së thelluar, KK konstatoi se tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, me pagesë, ka karakteristikat e një tregu duopol, me ndërmarrje me fuqi tregu; shoqëria Tring rezulton me një normë fitimi modeste dhe një kthim investimi shumë të ulët. Referuar çmimit të shitjes së paketave konstatohet se çmimi i paketave digjitale të ofruara nga Tring janë më të ulta se Digitalb, por treguesit financiar tregojnë se Tring nuk është në gjendje të konkurrojë; shoqëria ARTMOTION SHPK, është kompani e licencuar për të ofruar shërbimet e Internetit, televizionit dixhital, IPTV/OTT, TV Broadcaster si dhe ndërtim të nyjeve ndërkombëtare të internetit, me tregues shumë të mirë të performancës financiare; transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK pritet të ndikojë në rritjen e performancës financiare të shoqërisë target dhe për pasojë në nxitjen e aftësisë konkurruese të shoqërisë Tring TV SHA në tregun përkatës.

Për sa më sipër KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA.

➤ ***Tregu i hidrokarbureve/vajra lubrifikante.***

Në këtë treg, ka kaluar në procedurat e kontrollit dhe është autorizuar 1 transaksione:

1. Përfutimi i kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4 A-M SHPK.

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. nr. 1187, datë 26.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i import, transport, tregtim dhe magazinim i vajrave lubrifikante.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë 4 A-M SHPK ishte punime & instalime elektrike, tregtim imp-exp materiale, ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj

Shoqëria target, O-SP Albania SHA ushtronte aktivitet në tregun e importit dhe shitjes së vajrave lubrifikantë dhe klienti i vetëm i saj ishte shoqëria blerëse.

Transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim konglomerat pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operonin në tregje të ndryshme dhe për më tepër shoqëria target kishte patur marrëdhënie tregtare me shoqërinë 4 A-M SHPK.

Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshime në tregun përkatës

të produktit.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA.

2.5.2 Transaksione në tregun e jashtëm

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003, objekt i vlerësimit të përqendrimit janë transaksione, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm, por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

KK, për vitin 2025, ka autorizuar 28 raste transaksionesh, të renditura si më poshtë:

1. Vendimi nr. 1148, datë 14.01.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo”. Transaksioni ndodh në (i) tregun për zhvillimin dhe shitjen e platformave të automjeteve të përcaktuara nga softueri (Platforma SDV) dhe (ii) tregun për zhvillimin dhe shitjen e paketave të softuerit për vizionin dhe perceptimin për Sistemet e Avancuara të Ndihmës për Shoferin (ADAS) dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
2. Vendimi nr. 1149, datë 14.01.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve të dializës dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
3. Vendimi nr. 1151, datë 23.01.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë HBI ITALY ACQUISITION CO. S.R.L nga shoqëria ORBICO d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e tregtimit të veshjeve sportive dhe aksesoreve të tyre dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
4. Vendimi 1152, datë 23.01.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Shoqërive të Grupit Asia Pulp & Paper nga Z. Jackson Ejajaya Limantara”. Transaksioni ndodh në tregun për furnizimin e (i) celulozës së drurit dhe (ii) produkteve të letrës dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
5. Vendimi nr. 1155, datë 29.01.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset *franchised* të tregtimit të motorëve të drejtuar nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD”. Transaksioni ndodh në (i) tregun për shpërndarjen me pakicë të automjeteve të reja dhe automjeteve të përdorura të pasagjerëve (“PC”), (ii) tregun për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve dhe (iii) tregun për shitjen e pjesëve rezervë të automjeteve OE Porsche dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
6. Vendimi nr. 1158, datë 05.02.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Sauber Holding AG dhe filialeve të saj Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, nga shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft dhe Qatar Holding LLC.”. Transaksioni ndodh në (i) tregun për aktivitetet reklamuese / sponsorizuese të sporteve të automobilistikës për eventet e Formula 1 dhe, (ii) tregun për ofrimin e shërbimeve në lidhje me menaxhimin e një ekipi F1 dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
7. Vendimi nr. 1164, datë 20.03.2025 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT –

- STOCK COMPANY SAV 92”. Transaksioni ndodh në tregun e shitjes me shumicë të produkteve të konsumit të shpejtë dhe të produkteve kozmetike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
8. Vendimi nr. 1165, datë 20.03.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë AGFD TANDAREI SRL nga shoqëritë Ingredion Germany GmbH dhe AGRANA Stärke GmbH.” Transaksioni ndodh në tregun për prodhimin e produkteve amiloze dhe joamiloze dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 9. Vendimi nr. 1178, datë 14.05.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l. nga shoqëria SustainLink SARL”. Transaksioni ndodh në tregun për ofrimin e kapaciteteve të ndërlydhjes për transmetimin e energjisë elektrike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 10. Vendimi nr. 1182, datë 05.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve në turizmin detar dhe tregu për dhënien me qira të hapësirave komerciale dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 11. Vendimi nr. 1188, datë 26.06.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimeve të akomodimit në hotel dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 12. Vendimi nr. 1196, datë 21.07.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar, për përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA.”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të produkteve softuerike dhe shërbimeve të IT-së dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 13. Vendimi nr. 1199, datë 25.07.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë TOPCON CORPORATION nga shoqëria TK Co., Ltd. dhe indirekt nga KKR.”. Transaksioni ndodh në: (i) tregun e furnizimit me pajisje oftalmike dhe (ii) tregu i furnizimit me pajisje ndërtimi dhe kontroll makinerish dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 14. Vendimi nr.1203, datë 27.08.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfutimin e kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A.”. Transaksioni ndodh në tregun e : (i) shërbimeve me shumicë të lidhjes së internetit; (ii) shërbimeve ndërkombëtare me shumicë për operatorë; (iii) furnizimit me shumicë të shërbimeve të transmetimit të thirrjeve në rrjete ndërkombëtare; (iv) furnizimit me shumicë të shërbimeve Bulk SMS dhe (v) furnizimit me pakicë të shërbimeve të lidhjes për bizneset dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 15. Vendimi nr. 1205, datë 27.08.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verëaltungs-und Asset-Management GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe rishitjes së koncentreve të lëngjeve të frutave dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 16. Vendimi nr. 1206, datë 27.08.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar

- nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive Energotehnika-Južna Bačka doo Novi Sad dhe ELEKTROMONTAŽA D.O.O. KRALJEVO nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság”. Transaksioni ndodh në tregun e ndërtimit dhe mirëmbajtjes e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe energjisë elektrike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
17. Vendimi nr. 1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”. Transaksioni ndodh në (i) tregun e prodhimit, integritit dhe shpërndarjes së sistemeve fotovoltaike dhe (ii) tregun e prodhimit dhe furnizimit me shumicë të energjisë elektrike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 18. Vendimi nr. 1212, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfutimin e kontrollit të vetëm, indirekt, të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság”. Transaksioni ndodh në tregun e shitjes me pakicë dhe asistencës teknike në lidhje me furnizimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror për konsumatorët e grupit E.ON dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 19. Vendimi nr. 1213, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD”. Transaksioni ndodh në (i) tregun e shpërndarjes së kamionëve dhe autobusëve, dhe (ii) në tregun për ofrimin e shërbimeve pas shitjes për kamionët dhe autobusët dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 20. Vendimi nr. 1216, datë 26.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Njësisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A”. Transaksioni ndodh në tregun e shitjes së makinave të kafesë për përdorim shtëpiak dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 21. Vendimi nr.1224, datë 29.10.2025, “Mbi Autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evroplane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e ruajtjes dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 22. Vendimi nr.1230, datë 18.11.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi përfutimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, proizvodnja hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verëaltungs-und Asset-Management GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të mbushjeve për ëmbëlsira dhe produkteve të kakaos së menjëhershme dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 23. Vendimi nr. 1231, datë 18.11.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi përfutimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve farmaceutike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
 24. Vendimi nr. 1233, datë 26.11.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., ĚKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e dhënies me qira të hapësirave të destinuara për shitje me pakicë dhe nuk

do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

25. Vendimi nr. 1241, datë 12.12.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság”. Transaksioni ndodh në tregun e telekomunikacionit dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
26. Vendimi 1242, datë 12.12.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të automjeteve të mbrojtjes dhe ushtarake dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
27. Vendimi nr. 1243, datë 12.12.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Ai Sirona (Luxembourg) Acquisition S.À R.L. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.À R.L.”. Transaksioni ndodh në tregun e regjistrimit, promovimit, importit, shpërndarjes dhe shitjes së produkteve farmaceutike etj. dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
28. Vendimi nr. 1247, datë 19.12.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar nga shoqëria GEN – I SONCE, energetske storitve, d.o.o.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të energjisë elektrike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

PJESA E TRETË:

AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESEVE GJYQËSORE

AK i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave gjyqësore, duke qenë aktiv në të gjitha këto proçese në shkallët e gjykimit nëpërmjet paraqitjes së argumenteve dhe provave në mbështetje të vendimeve të marra nga KK.

Ndjekja e çështjeve gjyqësore lidhet me ndikimin që kanë vendimet e KK në tregun përkatës dhe në publikun e gjerë si dhe me faktin që pothuajse të gjitha vendimet e komisionit për marrje masash ndaj ndërmarrjeve, i janë nënshtruar proçesit të ankimimit në gjykatë.

3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2025, janë dhënë gjithsej 5 (pesë) vendime gjyqësore në çështje me objekt shfuqizimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, nga të cilat 4 (katër) janë rrëzuar dhe 1 (një) është pranuar.

Proçeset gjyqësore me palë të paditur AK, të cilat janë rrëzuar nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse, “Bloja SHA” dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizim VKK nr. 935, datë 16.12.2022 të Autoritetit të Konkurrencës “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021”;

2. Çështja gjyqësore me palë paditëse, “NEOFONE SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: Ndryshim i pjesshëm i VKK nr. 952, datë 28.12.2022 të Autoritetit të Konkurrencës “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania Sha në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënien e disa detyrimeve”;
3. Çështja gjyqësore me palë paditëse, ndërmarrjen “Star Parking Albania SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: Ndryshim i VKK nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit të komisionit të konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”;
4. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Tirana Administrim SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr. 1145, datë 27.12.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë, gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Tirana Administrim SHPK”.

Proçesi gjyqësor me palë të paditur AK, i cili është pranuar nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Antea Cement SHA” dhe të paditur AK, me objekt: Anulim/shfuqizim i VKK nr. 1091, datë 01.07.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë dhe gjobitjen e ndërmarrjes Antea Cement SHA për abuzim me pozitën dominuese”.

3.2 Çështje të gjykuara në gjykatën administrative të apelit Tiranë

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, gjatë vitit 2025, janë dhënë gjithsej 4 (katër) vendime gjyqësore në çështje me objekt shfuqizimin e vendimeve të KK, nga të cilat 3 (tre) janë rrëzuar dhe 1 (një) është pranuar:

Proçeset gjyqësore me palë të paditur AK, të cilat janë rrëzuar nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë janë si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Vodafone Albania SHA” dhe palë të paditur AK, me objekt: Shfuqizim VKK nr. 495 datë 08.02.2018 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për mos përmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017”.
2. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “EKMA Albania SHPK” dhe palë të paditur AK, me objekt: Shfuqizim i VKK nr. 542, datë 04.09.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agroushqimore në qytetin e Tiranës”;
3. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “SGS Automative Albania SHPK” dhe palë të paditur AK, me objekt: Shfuqizim tërësisht i VKK nr. 562, datë 25.10.2018, “Për vendosje

gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”;

Proçesi gjyqësor me palë të paditur AK, i cili është pranuar nga ana e Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë është si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse shoqëritë “AGROBLEND” SHPK; “MBM” SHPK; dhe “CACA” SHPK dhe palë të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr. 874, datë 25.03.2022 “Mbi hetimin e thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, ECO-GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO-MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP-SA SHPK dhe BESNIKU SHPK”.

3.3 Çështje të gjykuara në Gjykatën e Lartë

Pranë Gjykatës së Lartë, gjatë vitit 2025, është dhënë gjithsej 1 (një) vendim në çështje me objekt shfuqizimin e vendimeve të KK:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Landeslease SHA” dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizim i VKK nr. 412 datë 21.04.2016, në lidhje me pikën e parë që i përket Landeslease SHA.

Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të ndërmarrjes Landeslease SHA.

3.4 Ekzekutimi i vendimeve të komisionit të konkurrencës

KK për vitin 2025 ka marrë 9 (nëntë) vendime me gjobë, si më poshtë:

NR.	VENDIMI I KK	DEBITORË	VLERA E GJOBËS (në lekë)
1	1150/14.01.2025	M42 LTD	Ekzekutuar plotësisht 1,000,000
2	1184/05.06.2025	Agna SHA	Ekzekutuar plotësisht 10,000
		Inter Stock SHPK	Ekzekutuar plotësisht 10,000
3	1208/27.08.2025, korrigjuar me VKK 1209/11.09.2025	Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK	Ekzekutuar plotësisht 500,000
		PIAZ INVESTMENT DOO Skopje	Ekzekutuar plotësisht 10,000
4	1234/26.11.2025	Fruit - To - Zela	571,908
5	1235/26.11.2025	Besim Thaqi PF	237,911
6	1236/26.11.2025	Morina Grup shpk	676,107
7	1237/26.11.2025	Nedrete Arapi PF	423,005
8	1238/26.11.2025	Roland - 2012 shpk	355,172
9	1239/26.11.2025	Omer Fruit shpk	1,000,000

Vlera totale e gjobave të vëna në 2025:	4,794,103
Vlera e ekzekutuar nga gjobat e vëna gjatë vitit 2025:	1,530,000
Vlera e ekzekutuar nga gjobat e vëna gjatë viteve 2013-2024:	38,678,078
Vlera totale e ekzekutimit të gjobave për VKK 2013-2025:	40,208,078

- Nga këto vendime janë ekzekutuar plotësisht dhe vullnetarisht 3 (tre), të cilave i përkasin 5 (pesë) debitorë.
- AK është në pritje të plotësimit të afatit të ekzekutimit vullnetar për 3 (tre) vendimet e tjera me gjobë të vitit 2025, të cilave i përkasin 6 (gjashtë) debitorë.
- AK është në pritje të kryerjes së veprimeve përmbarimore për 7 (shtatë) urdhra ekzekutimi të cilat i përkasin vendimeve të KK përpara vitit 2025.
- Gjatë vitit 2025 janë ekzekutuar plotësisht ose pjesërisht 9 (nëntë) vendime të KK të cilat i përkasin viteve 2013-2024, si më poshtë:

NR.	VENDIMI I KK	NR.	DEBITOR	STATUSI
1	918/26.10.2022	1	Bankers Petroleum Albania LTD	Ekzekutuar pjesërisht 4,760,248 lekë
2	935/16.12.2022	2	Bloja SHA	Ekzekutuar plotësisht 1,468,877 lekë
3	290/23.07.2013	3	“Ferlut” SHA	Ekzekutuar plotësisht 1,600,751 lekë
		4	“Tirana Lines” Shpk	Ekzekutuar pjesërisht 720,288 lekë
4	572/22.11.2018	5	EKMA Albania shpk	Ekzekutuar plotësisht 27,709,505 lekë
5	1120/11.10.2024	6	FARMACOM SHPK	Ekzekutuar plotësisht 1,000,000 lekë
6	1121/11.10.2024	7	PHARMA ONE SHPK	Ekzekutuar plotësisht 1,000,000 lekë
7	1138/20.12.2024	8	Adastra SHPK	Ekzekutuar pjesërisht 93,000 lekë
		9	Colombo shpk	Ekzekutuar pjesërisht 238,809 lekë

Vlera totale e gjobave të ekzekutuara nga AK gjatë vitit 2025, ku përfshihen gjoba të vëna nga KK me vendime nga 2013-2025 është: **40,208,078.32** (Dyzet milionë e dyqind e tetë mijë e shtatëdhjetë e tetë presje tridhjetë e dy) **lekë**.

PJESA E KATËRT:

ADVOKACIA E KONKURRENCËS

Në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, AK, për arsye të interesit të përgjithshëm dhe në bashkëpunim me administratën qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, vlerëson barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ, të cilat mund të vijnë për shkak të a) kufizimeve sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; b) vendosjes së të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; c) imponimit të praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt akteve normative

AK ka dhënë mendim për 17 (shtatëmbëdhjetë) projektakte, si më poshtë:

1. Projektvendim “Për miratimin në parim të Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për inteligjencën artificiale, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës”;
2. Projektvendim “Për prodhimin dhe tregtimin nga ana e shoqërisë aksionare të industrisë së mbrojtjes, vetëm ose nëpërmjet subjekteve të tjera të krijuara prej saj të armëve ose pjesëve të tyre, municioneve, teknologjive, pajisjeve, veshjeve dhe mjeteve, të prodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, për tu përdorur nga strukturat e sigurisë, organet e varësisë së strukturave të sigurisë, apo shoqëri aksionare shtetërore të krijuara nga këto struktura sigurie”;
3. Draft Kodi Penal;
4. Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
5. Projektligj “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”;
6. Projektvendim “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut”;
7. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
8. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”;
9. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 131/2015, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
10. Projektligj “Për transformimin, bashkimet dhe ndarjet e shoqërive tregtare”;
11. Projektvendim “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 391, datë 03.05.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
12. Projektligj “Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit”;

13. Projektligj “Për statusin e Shoqërive Evropiane (SE)”;
14. Projektligj “Për grupimet ekonomike me interes Evropian”;
15. Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores mbi procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte që lidhen me ose ndikojnë infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike, qasjen në informacion të ndjeshëm apo për lirinë e medias”;
16. Projektvendim “Për transferimin të Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”, më nënprojekte “Korpusi i Institucioneve të Pavarura”, “Shtëpia e Fëmijëve Vlorë”, “Qendra për zhvillimin multifunksional”, “Copëzat”;
17. Vlerësim i Projekt-Rregullores së Analizës së Tregjeve.

Gjatë vitit 2025, AK ka realizuar vlerësimin e 26 projekt akte normative të Enteve Rregullatorë, për tregjet specifike, të cilët janë grupuar si më poshtë:

- *Tregu i shërbimeve celulare*

AKEP, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 11, datë 27.08.2025, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”.

Pas vlerësimit të dokumentit, KK me Vendimin nr. 1214, datë 26.09.2025, “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse””, vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që gjatë zbatimit të masave të parashikuara në dokumentin “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”, të ketë në vëmendje ndikimin që reduktimi i kostove të shumicës mund të prodhojë në tregun e pakicës, me qëllim sigurimin që përfitimet e rregullimit të reflektohen edhe në interes të konsumatorit final.

- *Tregu i energjisë dhe gazit*

ERE, gjatë vitit 2025, ka dërguar për vlerësim ligjor pranë AK projekt aktet normative në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si me poshtë vijon:

1. Vendim i ERE nr. 224, datë 23.10.2024 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së Alpex SHA “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022””, i ndryshuar;
2. Vendim i ERE nr. 251, datë 25.11.2024 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST SHA “Për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongestionave””;
3. Vendim i ERE nr. 265, datë 10.12.2024 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar”;

4. Vendim i ERE nr. 273, datë 13.12.2024 “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025”;
5. Vendim i ERE nr. 279, datë 16.12.2024 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025-2027”;
6. Vendim i ERE nr. 284, datë 18.12.2024 “Mbi miratimin e metodologjisë së përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme”;
7. Vendim i ERE nr. 288, datë 23.12.2024 “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”;
8. Vendim i ERE nr. 298, datë 30.12.2024 “Mbi lënien në fuqi të vendimeve të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022 dhe nr. 72, datë 15.04.2024”;
9. Vendim i ERE nr. 302, datë 30.12.2024 “Mbi shqyrtimin e propozimit të FTL SHA “Për draft “Marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet furnizuesit të tregut të lire SHA dhe prodhuesve me përparësi të energjisë””;
10. Vendim i ERE nr. 10, datë 08.01.2025 “Mbi përcaktimin çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e shërbimit universal të furnizimit për periudhën 1 shkurt 2025 - 31 dhjetor 2025”;
11. Vendim i ERE nr. 27, datë 27.01.2025 “Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”;
12. Vendim i ERE nr. 36, datë 10.02.2025 “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2024”;
13. Vendim i ERE nr. 37, datë 10.02.2025 “Mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 302 datë 30.12.2024”;
14. Vendim i ERE nr. 79, datë 14.04.2025 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”;
15. Vendim i ERE nr. 116, datë 03.06.2025 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST SHA Për miratimin “e një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”;
16. Vendim i ERE nr. 150, datë 08.07.2025 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST SHA “Për miratimin e një udhëzuesi “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike””;
17. Vendim i ERE nr. 290, datë 13.11.2025 “Mbi miratimin e rregullores “Për alokimin e kapaciteteve afatgjata””;
18. Vendim i ERE nr. 291, datë 13.11.2025 “Mbi miratimin e një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”;
19. Vendim i ERE nr. 293, datë 13.11.2025 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 93, datë 28.04.2025 “Mbi miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestioneve”;
20. Vendim i ERE nr. 294, datë 13.11.2025 “Mbi miratimin e udhëzimit “për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore dhe identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse”;
21. Vendim i ERE nr. 300, datë 17.11.2025 “Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s

nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”;

22. Vendim i ERE nr. 307, datë 21.11.2025 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Alpex SHA “Për përcaktimin e tarifave të nemo për vitet 2026 – 2028”.

- ***Spektori i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave:***

ERRU, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të spektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ka sjellë për vlerësim ligjor pranë AK projekt aktin normativ mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor, për Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA dhe Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA.

KK, me Vendimin nr. 1190, datë 26.06.2025 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- I. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- II. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

KK, me Vendimin nr. 1191, datë 26.06.2025 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- I. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- II. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

KK, me Vendimin nr. 1192, datë 26.06.2025 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- I. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- II. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

4.2 Promovimit i kulturës së konkurrencës

Gjatë vitit 2025, AK, në kuadër të promovimit të advokacisë dhe kulturës së konkurrencës, ka organizuar workshope dhe takime me grupet e interesit, botën akademike dhe mediat.

Në kuadër të projektit “Nxitja e zbatimit të ligjit, politikës së konkurrencës dhe e kulturës së

konkurrencës në Shqipëri” i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës (SECO) dhe mbështetur nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), gjatë vitit 2025 u realizuan:

- Trajnim për gjyqtarët dhe Shkollën e Magjistraturës në lidhje me çështje të konkurrencës në datat 20-21 Janar 2025
- Forumi ndërkombëtar “Mbrotjtja e konsumatorëve, nxitja e konkurrencës: perspektiva dhe strategji për tregjet gjithëpërfshirëse dhe digjitale në datën 22 janar 2025, organizuar nga AK dhe Komisioni i Mbrotjtjes së Konsumatorit.
- Në përfundim të projektit u organizuan **dy evente advokacie** në 19 nëntor 2025 prezantim dhe diskutim mbi manualin e përputhshmërisë për Shoqatat e Biznesit/Dhomat e Tregtisë. Më 20 nëntor 2025, u realizuan dy sesione të specializuara sektoriale për manualet e përputhshmërisë në sektorin e telekomunikacionit dhe shëndetësisë: tregu spitalor dhe farmaceutik.
- Trajnim me stafin e AK me prof, Frederic Jenny në datën 21 nëntor 2025.
- Gjithashtu projekti realizoi dhe një **video** për Programin e Lehtësimit nga Gjobat, e cila është publike në rrjetet sociale dhe Youtube.

AK zhvilloi më 8 Korrik 2025, në bashkëpunim me organizatën Qëndresa Qytetare, një **workshop**, me fokus në sfidat e konkurrencës në treg dhe forcimin e mirëqeverisjes përmes bashkëpunimit ndërinstitucional. Diskutimi i hapur mes pjesëmarrësve nxiti reflektime të rëndësishme mbi problematikat e trajtuara dhe hodhi bazat për bashkëpunime të mëtejshme për rritjen e transparencës dhe garantimin e konkurrencës së lirë në sektorët ekonomikë dhe publikë.

Më 5 nëntor 2025 u nënshkrua ***Marrëveshja e Partneritetit Institucional midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Qeverisë Gjermane*** për forcimin e zbatimit të ligjit të konkurrencës në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, një dokument i rëndësishëm që vendos bazat e një partneriteti të ri institucional midis Ministrisë Federale për Çështjet Ekonomike dhe Energjinë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Autoritetit të Konkurrencës. Nga kjo marrëveshje gjatë vitit 2026 do të realizohen trajnime dhe seminare për çështje të ndryshme të konkurrencës.

Gjatë vitit 2025, për herë të parë, AK realizoi ***konkursin e eseve*** me studentët e gjatë universiteteve. Në kuadër të Ditës së Konkurrencës, në datën 5 dhjetor 2025, Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si dhe me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, Fakultetin e Drejtësisë të Kolegjit Universitar Qirjazi, Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Epoka, Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar dhe Universitetin European të Tiranës, organizoi ceremoninë e ndarjes së çmimeve për konkursin e eseve kushtuar temave kyçe të së drejtës së konkurrencës.

AK do të vijojë nxitjen e organizimit dhe kthimin në traditë të aktiviteteve të tilla si një nga mënyrat më të mira për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës, përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike.

PJESA E PESTË

INTEGRIMI EVROPIAN dhe BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian

Proçesi i integrimit evropian përbën një nga prioritetet e veprimtarisë së AK. Si një institucion lider dhe koordinator për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, AK jep kontributin e tij në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), raporton në mënyrë periodike pranë Kryenegociatorit, për “Tregun e brendshëm dhe konkurrencën”, si dhe jep kontributin e tij për Progres Raportin.

➤ *Katër akte të përafruara me acquis-in e Bashkimit Evropian gjatë vitit 2025*

Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe në përputhje me Planin e Punës për adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”, të përcaktuara nga Komisioni Evropian pas hapjes së negociatave për këtë kapitull në prill 2025 dhe dorëzimit të pozicionit të përbashkët negociues nga Komisioni Evropian, Komisioni i Konkurrencës ka ndërmarrë një sërë masash konkrete për përafrimin e kuadrit ligjor dhe forcimin e zbatimit të tij.

Në këtë kuadër, duke reflektuar edhe rekomandimet dhe orientimet e dhëna gjatë takimeve shpjeguese dhe monitoruese të zhvilluara me Komisionin Evropian gjatë vitit 2025, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar aktet si më poshtë:

1. Me Vendimin nr. 1217, datë 26.09.2025, ka miratuar Rregulloren “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit” në përputhje me ‘Rregulloren e Komisionit Evropian Nr. 1066/2023 “Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për disa kategori të marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit”.
2. Me Vendimin nr. 1248, datë 19.12.2025, ka miratuar Rregulloren “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit” në përputhje me ‘Rregulloren Nr. 1067/2023 e Komisionit Evropian “Mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian në kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit”.
3. Me Vendimin nr. 1249, datë 19.12.2025, ka miratuar Rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara” në përputhje me ‘Rregulloren Nr. 720/2022 e 10 Majit 2022 mbi aplikimin e nenit 101(3) të Traktatit të Funksionimit të BE-së për disa kategori marrëveshjesh vertikale dhe praktikave të bashkërenduara, e cila zëvendëson rregulloren Nr. 330/2010, datë 20.04.2010.
4. Me Vendimin nr. 1250, datë 19.12.2025, ka miratuar Udhëzimin “Mbi kufizimet vertikale” në përputhje me ‘Udhëzimin e Komisionit Evropian “Mbi kufizimet vertikale” (2022/C 248/01).

AK ka realizuar plotësisht Planin Kombëtar për Integrimin Evropian për vitin 2025.

- *Në kuadër të Platformës së Partneritetit të Integrimit Evropian (PPIE), e cila shërben si një mekanizëm i rëndësishëm konsultimi me grupet e interesit për të diskutuar progresin e reformave dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian, janë organizuar 5 (pesë) takime.*

Kjo platformë ofron një hapësirë të strukturuar për dialog midis autoriteteve shqiptare dhe aktorëve të ndryshëm të sektorit privat, shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera të përfshira. Përmes këtyre takimeve, grupet e interesit kanë mundësinë të japin vërejtje, sugjerime dhe rekomandime për projektaktet dhe masat e ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës. Rëndësia e platformës qëndron në rolin e saj për të siguruar transparencë, përfshirje dhe konsultim të gjerë, duke mundësuar një proces të mirëinformuar dhe të harmonizuar me pritshmëritë e Bashkimit Evropian në kuadër të integritetit të Shqipërisë.

1. Takimi i parë është zhvilluar në datë 06.02.2025 ku fokusi ishte tek konsultimi me grupet e interesit në lidhje me Draft Pozicionin Negociues për Kapitullin 8.
2. Takimi i dytë është zhvilluar në datë 16.09.2025 ku fokusi ishte tek diskutimet, komentet, sugjerimet në lidhje me Draft-Rregulloren “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit”.
3. Takimi i tretë është zhvilluar në datë 19.11.2025 ku fokusi ishte tek prezantimi dhe konsultimi i Manualit të Përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës për Shoqatat e Biznesit.
4. Takimi i katërt është zhvilluar në datë 20.11.2025 ku fokusi ishte tek prezantimi dhe konsultimi i Manualeve të Përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës në sektorin e telekomunikacionit dhe shëndetësisë (tregu spitalor dhe farmaceutik).
5. Takimi i pestë është zhvilluar në datë 04.12.2025 ku fokusi ishte tek diskutimet, komentet, sugjerimet në lidhje me Rregulloren “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit”, Rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, Udhëzimin “Mbi kufizimet vertikale”, për nivelin e përafrimit me Direktivën (BE) 2019/1 (ECN+) me legjislacionin shqiptar si dhe Drafti i Kodit Penal.

➤ *Nënkomiteti “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit & Shëndetit”*

Takimi i 16 - të i Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit & Shëndetit”, u zhvillua në 26 Qershor 2025 online.

AK paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit si dhe lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e KK, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe procesin e përafrimit të legjislacionit.

5.2 Memorandume Bashkëpunimi

AK vijon të synojë zgjerimin e bashkëpunimit me Autoritetet e Konkurrencës së vendeve të rajonit dhe më gjerë, me qëllim promovimin dhe rritjen e kulturës së konkurrencës.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Konkurrencës ka zyrtarizuar bashkëpunimin me 4 institucione: më 22 janar 2025 me Komisionin i Mbrojtjes së Konsumatorit; më 4 mars 2025 me Kolegjin

Universitar “Qiriazi”; më 20 maj 2025 me Universitetin EPOKA dhe më 17 nëntor 2025 me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FDUT), përmes nënshkrimit të një Marrëveshje Bashkëpunimi, me qëllim forcimin e kulturës së konkurrencës dhe promovimin e advokacisë së konkurrencës për studentët dhe stafin akademik.

5.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

5.3.1 Aktivitete

Gjatë vitit 2025, AK ishte përfitues i projektit Multi-Kombëtar të instrumentit të BE-së TAIEK mbi forcimin e kapaciteteve për zbatimin efektiv të ligjit të konkurrencës, në bashkëpunim me AZZK (Mali i Zi) dhe Zyrën Polake të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit UOKiK (Poloni), nëpërmjet të cilit u synua trajnimi i stafit të dy autoriteteve të konkurrencës dhe gjyqtarëve.

Në kuadër të projektit u zhvilluan 2 *workshope* në datat:

- 20-21 tetor 2025, në Podgoricë, ku kanë marrë pjesë 10 (dhjetë) punonjës,
- 3-4 nëntor 2025 në Tiranë, ku mori pjesë i gjithë stafi i AK.

Gjatë dy aktiviteteve morën pjesë gjyqtarë nga Mali i Zi dhe nga Shkolla Shqiptare e Magjistraturës, Gjykata e Shkallës së parë Tiranë dhe Gjykata e Apelit.

Këto workshop-e kishin si qëllim përvetësimin e përvojës evropiane dhe shkëmbimin e eksperiencave në procedurat antitrust dhe sfidat e reja për autoritetin e konkurrencës në përballjet me tregjet ekzistuese, ato sensitive dhe tregjet e reja. Në këtë workshop-e mori pjesë i gjithë stafi i AK, me synim zgjerimin e njohurive dhe përditësimin profesional mbi legjislacionin dhe metodologjinë që duhet ndjekur gjatë trajtimit të rasteve të abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe marrëveshjeve në prokurimet publike. Gjithashtu, stafi i AK u njoh me përvojën polake mbi Programin e Lehtësimit nga Gjjobat, implementimit të Direktivës ECN+ në Poloni, tregjet digjitale dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të konkurrencës dhe rregullatorëve sektorialë.

Gjithashtu, gjatë veprimtarisë së vitit 2025, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë.

Stafi i AK është trajnuar në kuadër të bashkëpunimit me organizatat, si më poshtë vijon:

– Në kuadër të bashkëpunimit me OECD - GVH/RCC janë realizuar 3 *seminare* si më poshtë:

1. Në datat 18–20 mars 2025 u zhvillua nga RCC seminari me temë “Turizmi, transporti dhe konkurrenca”, në Bilbao, Spanjë, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
2. Në datat 4–6 nëntor 2025 u zhvillua nga RCC seminari me temë “Kur shteti dëmton konkurrencën: Shkeljet dhe reagimet e mundshme, Ndërmarrjet Shtetërore dhe neutraliteti konkurrues”, në Lubjanë, Slloveni, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
3. Në datat 18–20 nëntor 2025 u zhvillua seminari nga RCC “Ndërtimi i një rasti të fortë konkurrues në tregjet tradicionale”, në Almaty, Republika e Kazakistanit, ku ka marrë pjesë 1(një) punonjës.

➤ **Konferenca (9)**

1. Në datat 27–28 shkurt 2025 u zhvillua nga RCC konferenca e 20 vjetorit të saj “Politika Industriale dhe Konkurrenca”, në Budapest, Hungari, ku kanë marrë pjesë 3 (tre) punonjës.
2. Në datën 14 prill 2025 u zhvillua nga KE, Konferenca ndërqeveritare IV me temë “Hapja e Grupkapitullit II–”Tregu i Brendshëm”, në Luksemburg, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
3. Në datat 7–9 maj 2025 u zhvillua nga ICN, Konferenca vjetore e ICN, në Edinburg, Skoci ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
4. Në datat 26–27 maj 2025 u zhvillua nga Autoriteti Austriak i Konkurrencës në bashkëpunim me Bankën Botërore, Konferenca e rrjetit të autoriteteve të konkurrencës, në Vjenë, Austri, ku kanë marrë pjesë 3 (tre) punonjës.
5. Në datat 12–13 qershor 2025 u zhvillua nga Instituti Tilburg për Drejtësinë, Teknologjinë dhe Shoqërinë (TILT), Konferenca Ndërkombëtare me temë “Një Rregullore Financiare e Popullit? Ligji i Konkurrencës dhe Ekonomia në Sektorin e Shërbimeve Financiare”, në Tilburg, Holandë, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
6. Në datat 7–11 korrik 2025 u zhvillua nga UNCTAD, Konferenca e Nëntë e Kombeve të Bashkuara, në Gjenevë, Zvicër, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
7. Në datat 23–24 tetor 2025 u zhvillua nga Autoriteti Portugez i Konkurrencës, Konferenca e VII-të e Lisbonës mbi të Drejtën dhe Ekonominë e Konkurrencës, në Lisbonë, Portugali, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
8. Në datat 13–15 nëntor u zhvillua nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Konsumatorit të Gjeorgjisë, Konferenca Ndërkombëtare mbi Konkurrencën dhe Mbrojtjen e Konsumatorit, në Tbilisi, Gjeorgji, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
9. Në datën 26 maj 2025 u zhvillua nga UOKIK “Dita Evropiane e Konkurrencës” në Varshavë, Poloni, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.

➤ **Takime (5)**

1. Në datën 5–6 mars 2025 u zhvillua nga Autoriteti i Konkurrencës së Malit të Zi. Takim prezantues me Autoritetin e Konkurrencës së Malit të Zi, në Podgoricë, Mali i Zi, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
2. Në datat 2-4 prill 2025 u zhvillua nga ABA. Takimi pranveror për ligjin antitrust, në Washington, USA, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
3. Në datat 14–15 prill 2025 u zhvillua nga Autoriteti Turk i Konkurrencës. Takimi me Autoritetin Turk të Konkurrencës, në Ankara, Turqi, ku kanë marrë pjesë 3 (tre) punonjës.
4. Në datat 23–25 Shtator 2025 u zhvillua nga Lear “Festivali i Konkursit Lear 2025”, në Romë, Itali, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
5. Në datë 20 tetor 2025 u zhvillua nga Komisioni Helen i Konkurrencës, “Festimi i 30–vjetorit të Komisionit Helenik të Konkurrencës”, në Athinë, Greqi, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.

➤ **Forum (2)**

1. Në datën 30 janar 2025 u zhvillua nga Forumi Kapitol, seminari me temë “Stuhia e përkryer: Koha e së vërtetës për Evropën?”, në Bruksel, Belgjikë, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
2. Në datat 1–2 Dhjetor 2025 u zhvillua nga OECD Forumi Global mbi Konkurrencën, në Paris, Francë ku kanë marrë pjesë 3 (tre) punonjës.

➤ **Workshop (7)**

1. Në datat 4–5 shkurt 2025 u zhvillua nga TAIEX workshop-i me temë “Mbi transpozimin e aktit të tregut dixhital të BE-së (DMA) në shtetet anëtare të BE”, në Bruksel, Belgjikë, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
2. Në datën 26 shkurt 2025 u zhvillua nga OECD seminari me temë “Dita e hapur e konkurrencës”, në Paris, Francë, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
3. Në datën 12–14 mars 2025 u zhvillua nga ICN workshop-i me temë “Sjellja e njëanshme”, në Rio de Janeiro, Brazil, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
4. Në datën 23–25 prill 2025 u zhvillua nga ICN workshop-i me temë “Workshop për Krye Ekonomist dhe Senior”, në Budapest, Hungari, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
5. Në datën 15–17 tetor 2025 u zhvillua nga ICN workshopi me temë “Bashkimi i ICN-së 2025”, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.
6. Në datën 20-21 tetor 2025 u zhvillua nga TAIEX workshopi me temë “TAIEX Multi-Country Workshop on Capacity Building for Effective Competition Enforcement STATE AID”, në Podgoricë, Mali i Zi, ku ka marrë pjesë 10 (dhjetë) punonjës.
7. Në datat 10 - 12 dhjetor 2025, u realizua vizita studimore në Varshavë, Poloni. Ky aktivitet kishte si qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ofrimin e ekspertizës në fushën e mbrojtjes së konkurrencës. Vizita synoi shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në prezantimet e përfaqësuesve të UOKiK dhe AZZK në fushën e konkurrencës, ku kanë marrë pjesë 5 (pesë) punonjës.

➤ **Trajnime (2)**


1. Në datat 24–28 shkurt 2025 u zhvillua nga Joint Vienna trajnimi me temë “Çështje të përzgjedhura në rregullimin dhe mbikëqyrjen e Fintech”, në Vjenë, Austri, ku ka marrë pjesë 1 (një) punonjës.
2. Në datat 13–14 Tetor 2025 u zhvillua nga Komisioni Evropian (DG Competition) trajnimi me temë “Mbi Konkurrencën dhe Ndhimën Shtetërore”, në Bruksel, Belgjikë, ku kanë marrë pjesë 2 (dy) punonjës.

PJESA E GJASHTË

ORGANIZIMI I AUTORITETIT

6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës

Për vitin 2025, Autoriteti i Konkurrencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, ka pasur si objektiv strategjik të tij, për t'u afruar sa më shumë me modelin institucional të institucioneve homologe të vendeve të BE. Autoriteti i Konkurrencës është i organizuar nga një numër prej 49 punonjësish, sipas strukturës së miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 25/2024 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës”.




6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, përdorimi i buxhetit të miratuar për AK ka qenë konform kërkesave të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe është përdorur me efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve, për realizimin e detyrave të ngarkuara për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

(në lekë)

Kodi	Emërtimi	Plani (me ndryshime)	Fakti	%
600	Paga, shpërblime etj	89,300,000	76,179,164	85%
601	Kontribute për sigurime shoqërore	12,240,000	12,156,444	99%
602	Materiale dhe shërbime	27,686,000	25,956,819	94%
606	Ndihma ekonomike	874,000	526,110	60%
231	Investime	7,900,000	5,405,040	68%
Totali		138,000,000	120,223,577	87%

STRUKTURA BUXHETORE PËR VITIN 2025



6.3 Të ardhurat e realizuara

Deri më 31 dhjetor 2025, AK ka derdhur në buxhetin e shtetit rreth 71.425 milion lekë, nga të cilat: shuma prej 31,200,000 lekë janë të ardhura nga procedurat që ndiqen pranë AK (njoftime / autorizime përqendrimi dhe përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve) dhe 40,208,078.32 lekë janë të ardhura të arkëtuara nga vjelja e gjobave.

Të ardhura të arkëtuara	Viti
	2025
Nga procedurat pranë AK	31,200,000.00 Lekë
Nga gjobat	40,208,078.32 Lekë
Të tjera	17,100.00 Lekë
Total	71,425,178.32 Lekë

6.4 Trajnimet dhe rekrutimet

Gjatë vitit 2025, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive të Autoritetit të Konkurrencës janë realizuar 5 procedura rekrutimi, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 28 aktivitete jashtë vendit dhe 17 trajnime brenda vendit, ndër të tjera dhe webinarë informuese nga ASPA. Është trajnuar pothuaj i gjithë stafi teknik i ins titucionit, ku një pjesë e punonjësve rezulton të jenë trajnuar më shumë se një herë, si më poshtë vijon:


1. Në datë 18 shkurt 2025, është zhvilluar trajnimi në klasë me certifikim "Hartimi i shkresave zyrtare", nga Shkolla e Administratës Publike, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
2. Në datat 19-20 shkurt 2025, është zhvilluar kursi online me certifikim "Qeverisja elektronike", nga Shkolla e Administratës Publike, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
3. Në datat 25-27 shkurt 2025, është zhvilluar trajnimi në klasë me certifikim "Llojet e fondeve të BE-së, planifikimi dhe aplikimi për fonde", nga Shkolla e Administratës Publike, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
4. Në datat 26 mars-3 prill 2025, është zhvilluar trajnimi me studio ligjore "Miratimi dhe zbatimi i rregullave të konkurrencës të Bashkimit Evropian në Shqipëri", në kuadër të

bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ku kanë marrë pjesë disa nga punonjësit e Autoritetit të Konkurrencës.


5. Në datën 9 maj 2025, është zhvilluar online trajnimi mbi përdorimin e Modulit të Transparencës, në kuadër të kërkesave për informacion në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
6. Në datat 27, 28 dhe 29 maj 2025, është zhvilluar trajnimi "Prokurimi publik", nga Shkolla e Administratës Publike, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
7. Në datën 12 shtator 2025, është zhvilluar trajnimi online me certifikim "Forcimi i Transparencës Publike: Zbatimi i Ligjit nr. 119/2014 dhe Standardet e Konventës së Tromsøs", nga Shkolla e Administratës Publike, në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
8. Në datën 21 nëntor 2025, është zhvilluar trajnimi në përmbyllje të projektit "Nxitja e ligjit, politikës së konkurrencës dhe kulturës së konkurrencës në Shqipëri", në kuadër të bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës (SECO) dhe mbështetur nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), ku ka marrë pjesë stafi i Autoritetit të Konkurrencës.

Të gjitha trajnimet jashtë vendit janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me RCC, OECD, KE, ABA, UNCTAD, TAIEX dhe ato brenda vendit nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA).


Aktivitete jashtë vendit



Dite trajnimi 2025



Aktivitete dhe Trajtime 2025



■ Ditë trajnimi në Ekonomi ■ Ditë trajnimi në Legjislacion ■ Trajtime jashte vendit ■ Trajtime brenda vendit

PJESA E SHTATË

PRIORITETET E AK PËR VITIN 2026

7.1 Zbatimi i ligjit

Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si:

- Tregu i telefonisë celulare;
- Tregu i hidrokarbureve;
- Tregu i prokurimeve;
- Tregu bankar;
- Tregu sigurimeve;
- Tregu farmaceutik;
- Tregu i produkteve të shportës ushqimore;
- Tregu i transportit detar;
- Tregu i tregimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë.

Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë rast pas rasti sjelljen e ndërmarrjeve të cilat gëzojnë pozitë dominuese nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare.

7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE

Në përputhje me pozicionin negociues për Kapitullin 8, si dhe me Planin e Punës për adresimin e piketave mbyllëse të përcaktuara nga Komisioni Evropian në prill 2025, për vitin 2026 në fushën e konkurrencës parashikohet hartimi i 12 rregulloreve dhe udhëzimeve. Këto akte kanë për qëllim të plotësojnë dhe të forcojnë kuadrin ligjor dytësor, duke siguruar një zbatim më efektiv dhe harmonizim të praktikave me standardet e Bashkimit Evropian, konkretisht:

1. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1419/2006, datë 25 shtator 2006, për shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 4056/86, që përcaktonte rregulla të hollësishme për zbatimin e neneve 85 dhe 86 të Traktatit për transportin detar, si dhe për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 1/2003 në lidhje me shtrirjen e fushës së saj të zbatimit për të përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare tramp;
2. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 411/2004, datë 26 shkurt 2004, për shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 3975/87 dhe për ndryshimin e Rregulloreve (KEE) nr. 3976/87 dhe (KE) nr. 1/2003, në lidhje me transportin ajror ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta;
3. Komunikim i Komisionit – Ndryshime në Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve;
4. Njoftimi i Komisionit i datës 18 dhjetor 1978, lidhur me vlerësimin e disa marrëveshjeve të nënkontraktimit në raport me nenin 85(1) të Traktatit;
5. Njoftimi i Komisionit mbi përkufizimin e tregut përkatës për qëllime të së drejtës së

konkurrencës së Bashkimit Evropian (C/2024/1645);

6. Njoftim i Komisionit – Udhëzime plotësuese mbi kufizimet vertikale në marrëveshjet për shitjen dhe riparimin e mjeteve motorike dhe për shpërndarjen e pjesëve të këmbimit për mjetet motorike;
7. Komunikim i Komisionit mbi kuantifikimin e dëmit në paditë për dëmshpërblim të bazuara në shkeljet e neneve 101 ose 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;
8. Njoftimi i Komisionit – Udhëzime mbi konceptin e ndikimit në tregti, të përfshirë në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;
9. Direktiva (BE) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, për fuqizimin e autoriteteve kombëtare të konkurrencës për një zbatim më efektiv dhe për garantimin e funksionimit të rregullt të tregut të brendshëm (Direktiva ECN+);
10. Njoftimi i Komisionit mbi trajtimin e thjeshtuar të disa përqendrimeve, sipas Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (2023/C 160/01);
11. Udhëzues mbi përgatitjen e versioneve publike të vendimeve të Komisionit, të miratuara në bazë të Rregullores për përqendrimet;
12. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/914, datë 20 prill 2023, për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve dhe për shfuqizimin e Rregullores së Komisionit (KE) nr. 802/2004.

Forcimin e kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Adresimin në mënyrë të përshtatshme dhe domethënëse të çështjeve sensitive (trajtimi i ankesave), si dhe bashkëpunimin me institucionet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e RSH për të siguruar një konkurrencë efektive në treg.

Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe ente rregullatorë, duke nënshkruar me to edhe memorandume mirëkuptimi (MOU).

Në vijim të Marrëveshjes së Partneritetit Institucional midis AK, Qeverisë Gjermane, si dhe GIZ, për forcimin e zbatimit të ligjit të konkurrencës në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, një dokument i rëndësishëm që vendos bazat e një partneriteti të ri institucional midis Ministrisë Federale për Çështjet Ekonomike dhe Energjinë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, gjatë vitit 2026 do të realizohen trajnime dhe seminare për çështje të ndryshme të konkurrencës.

Me mbështetjen e GIZ prioritet i AK për 2026 është edhe përditësimi i Politikës së Konkurrencës, i cili do të jetë një dokument strategjik afatgjatë që do të konsultohet edhe me palët e interesit.